REPUBLIKA E SHQIPËRISË

USHTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Viti i 71-të i botimit Nr. 52 (827597) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 28 Dhjetor 2018

KREMTOHET 93 VJETORI I FORCËS DETARE SHQIPTARE



Detarët tanë kanë shkruar historinë e tyre të lavdishme

Më datën 19 dhjetor 2018, në Komandën e Forcës Detare, Plepa, Durrës, u festua 93-vjetori i Krijimit të Flotës sonë Luftarake Detare. Në këtë festë të detarëve tanë morën pjesë krahas kuadrove dhe detarëve të Forcës Detare dhe ish-kuadro të Flotës Luftarake, veteranë të saj, që kanë shërbyer në vite, në anije dhe baza të rëndësishme të Flotës, për gjatë gjithë bregdetit shqiptar. Gjithashtu për të nderuar festën e detarëve dhe kontributin e tyre në vite, mori pjesë dhe Ministri i Mbrojtjes zonja Olta Xhaçka, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjeneralbrigade Bardhyl Kollcaku, ish-Presidenti Rexhep Mejdani, kuadro të Ministrisë së Mbrojtjes…

» faqe 4

Komanda Mbështetëse-Batalioni i Xhenios

EOD: Kontingjenti IV me 23 efektivë niset me mision në Letoni

Efektivët tanë janë pjesë e Misionit të Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s, i cili udhëhiqet nga forcat kanadeze

» faqe 2



"Ju na jepni forcë me buzëqeshjen tuaj"

Festa e fëmijëve në Garnizonin e Vaut të Dejës



» faqe 3

Komanda Mbështetëse

FA në aksion për mbjelljen e 2.000 pemëve në Vaqarr

Pjesëtarë të Forcave të Armatosuras iu bashkuan aksionit të bashkisë Tiranë duke mbjellë fidanë të rinj pranë liqenit Liqenit të Vaqarrit për pasurimin e hapësirave të gjelbra të kryeqytetit. Duke e cilësuar një nismë të jashtëzakonshme, në emër të Forcave të Armatosura, kolonel Përparim Gega, zëvendëskomandant...



» faqe 2



TRUMP EMËRON SEKRETARIN E RI TË MBROJTJES

Pas dorëheqjes së James Mattis vjen Patrick Shanahan

» faqe 2

FORCA TOKËSORE

Medalja "Repart i Shquar" për Batalionin e Dytë të Këmbësorisë

faqe 5

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

Çfarë është Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (SCSDS)

faqe 7

Forca Ajrore

Analiza për 2018-tën dhe objektivat 2019. Stërvitjet ajrore sipas standardeve të NATO-s

Forca Ajrore Shqiptare, si strukturë përbërëse e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2018, ka realizuar me përgjegjësi dhe profesionalizëm të gjitha detyrat e ngarkuara që rrjedhin nga Direktiva e Ministrit të Mbrojtjes dhe misioni i kësaj Force. Për një analizim të këtyre realizimeve, por edhe problematikave të hasura gjatë vitit, më datën 21 dhjetor 2018, në Komandën e Forcës Ajrore...

» faqe 5



Komanda Mbështetëse-Batalioni i Xhenios

EOD: Kontingjenti IV me 23 efektivë niset me mision në Letoni

Efektivët tanë janë pjesë e Misionit të Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s, i cili udhëhiqet nga forcat kanadeze

Në mjediset e Batalionit të Xhenios (bXh) të Komandës Mbështetëse u zhvillua ditën e premte, më 21 dhjetor 2018, ceremonia e nisjes së Kontingjentit IV, EOD, i cili do të marrë pjesë për 6 muaj në Camp Abazi, si pjesë e misionit të Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence-eFP) të NATO, si pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze të dislokuara në Letoni.

Ceremonia e përcjelljes së kontingjentit u zhvillua në mjediset e Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse. Përveç kontigjentit dhe personelit të këtij batalioni në ceremoni merrnin pjesë edhe përfaqësues nga komanda dhe shtabi i KM, të kryesuar nga zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Përparim Gega, komandantët e reparteve të vartësisë të kësaj komande si dhe familjarët e pjesëtarëve të kontingjentit.

Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i bXh, nënkolonel Hajdar Gurra, i cili pasi falënderoi të pranishmit për prezencën e tyre, e vuri theksin edhe në rëndësinë dhe veçantinë e këtij misioni për kontingjentin IV të togës EOD. Nënkolonel Gurra u shpreh: "Tashmë janë bërë të zakonshme ceremonitë ku ne mblidhemi për nisjen e efektivave EOD në misionet jashtë vendit, ku pa kaluar një muaj nga nisja e kontigjentit të VII EOD në misionin trajnues në Mali, kemi nderin dhe privilegjin të përcjellim 23 efektive EOD drejt Letonisë. Këta djem dhe vajza do të vazhdojnë të kontribojnë dhe mbajnë lart flamurin tonë duke ofruar kapacitetin EOD, i cili është konsideruar një kapacitet shumë i rëndësishëm mbështetës për grup-batalionin kanadez të dislokuar në Letoni.

Zëvendës komandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Përparim Gega, në fjalën e tij përshëndetëse midis të tjerash u shpreh se: "Ne emër të komandantit dhe të Shtabit të Komandës Mbështetëse ndihemi krenarë me përfaqësimin dhe kontributin e deritanishëm që trupat xheniere dhe veçanërisht ato të EOD kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin në këtë mision kaq të rëndësishëm. Nisur nga këto arritje, shtabi dhe komandanti i KM janë të bindur se edhe ju do të jeni vazhdues të denjë të rrugës së nisur nga kontigjentet e mëparëshme".

Më tej, ceremonia vazhdoi me dorëzimin e flamurit për kontingjentin e IV EOD që niset në Letoni dhe u mbyll me një foto të përbashkët. Në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence-eFP) të NATO në Letoni do të marin pjesë 23 efektivë EOD, të cilët do të zëvendësojnë kontigjentin III, i cili pritet të kthehet këto ditë në atdhe.

PRESIDENTI TRUMP EMËRON SEKRETARIN E RI TË MBROJTJES

Pas dorëheqjes së James Mattis vjen Patrick Shanahan

Zv/sekretari i Mbrojtjes, Patrick Shanahan, është emëruar shef i ri Pentagonit, njoftoi të dielën, më 23 dhjetor, Presidenti Donald Trump.

"Është kënaqësi për mua të njoftoj se zëvendësministri i Mbrojtjes, Patrick Shanahan, do të shërbejë si ministër i Mbrojtjes prej 1 janar 2019. Patrick ka një listë të gjatë të arritjeve gjatë shërbimit si zëvendësministër i Mbrojtjes dhe më parë në 'Boeing'. Ai do të jetë i shkëlqyeshëm," tha Trump.Shanahan, një ish-ekzekutiv i kompanisë Boeing, u emërua Zëvendës Sekretari i Mbrojtjes në vitin 2017.

Patrick Shanahan u emëruar Sekretari Amerikan i Mbrojtjes, pas dorëheqjes së James Mattis i cili tha në letrën e dorëheqjes më 21 dhjetor se pikëpamjet e tij nuk janë plotësisht "të përafërta" me ato të presidentit Donald Trump.

"Meqë keni të drejtë të keni një sekretar të Mbrojtjes, pikëpamjet e të cilit janë më të harmonizuara me të tuat mbi këto dhe çështje të tjera, besoj se është e drejtë që unë të jap dorëheqje", shkroi gjenerali Mattis në letrën e tij.

Presidenti Trump njoftoi së pari largimin e sekretarit Mattis në Twitter, duke thënë se ish gjenerali me katër yje do të dalë në pension.

Letra e James Mattis u bë publike shumë shpejt pasi Trump shkroi në Twitter se Mattis do të pensionohet në fund të muajit shkurt. Ndërsa Shanahan do ta marrë rolin e tij më 1 janar.





Presidenti amerikan, Donald Trump, përmes rrjetit social Twitter tha se "Patrick ka një listë të gjatë të arritjeve". Patrick Shanahan ka lindur më 27 korrik 1962, në Aberden-Washington. Aberdeen është një qytet në Greys Harbor County, Washington, Shtetet e Bashkuara. Popullsia e rregjistruar në vitin 2010 ishte 16.896 banorë. Qyteti është qendra ekonomike e Grays Harbor County, në kufi me qytetet Hoquiam dhe Cosmopolis. Aberdeen shpesh quhet "Porta e Gadishullit Olimpik" dhe "Shtëpia e Kurt Cobain".

Shanahan ndoqi Universitetin e Washingtonit ku fitoi një diplomë Bachelor në Shkenca (B.S.) në inxhinieri mekanike. Ai gjithashtu ka një diplomë Master në Shkenca (M.S.) në inxhinieri mekanike nga Massachusetts Institute of Technology dhe një Master në Administrim Biznesi (MBA) nga MIT Sloan School of Management. Shanahan u bashkua me Boeing në vitin 1986, duke u përfshirë në Shërbimet Kompjuterike dhe programin Boeing 777. Gjatë karrierës së tij, ai ka mbajtur rol udhëheqës në lidhje me Sistemet e Mbrojtjes së Raketave Boeing.


Shanahan shërbeu si zëvendëspresident dhe menaxher i përgjithshëm i sistemeve të mbrojtjes raketore Boeing, duke filluar në dhjetor 2004 duke mbikëqyrur sistemin e Mbrojtjes Midcourse në terren, Airborne Laser dhe Advanced Tactical Laser. Ai shërbeu si zëvendëspresident dhe menaxher i përgjithshëm i programit Boeing 787 Dreamliner, ku ai udhëhoqi programin gjatë një periudhe kritike të zhvillimit të avionit nga 2007 në 2008. Ai më pas shërbeu si zëvendëspresident i lartë i programeve të avionëve në aeroplanët komercial të Boeing, duke filluar në dhjetor 2008. Në prill të vitit 2016, ai u bë zëvendëspresident i lartë, Zinxhiri i Furnizimit dhe Operacionet, për Boeing. Përgjegjësitë e tij në këtë pozicion përfshijnë operacionet e prodhimit dhe funksionet e menaxhimit të furnitorëve. Shanahan ishte anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Boeing. Më 16 mars 2017, Presidenti Trump njoftoi emërimin e Shanahan si Zëvendës Sekretarin e Mbrojtjes, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

KOMANDA MBËSHTETËSE

FA në aksion për mbjelljen e 2.000 pemëve në Vaqarr

Pjesëtarë të Forcave të Armatosuras iu bashkuan aksionit të bashkisë Tiranë duke mbjellë fidanë të rinj pranë liqenit Liqenit të Vaqarrit për pasurimin e hapësirave të gjelbra të kryeqytetit.

Duke e cilësuar një nismë të jashtëzakonshme, në emër të Forcave të Armatosura, kolonel Përparim Gega, zëvendëskomandant i Komandës Mbështetëse, shprehu gatishmërinë që ky kontribut i efektivëve të vijojë edhe në nisma të tjera të bashkisë së Tiranës. "Një nismë jashtëzakonisht të mirë që i shërben komunitetit, po pse jo edhe Forcës së Armatosur. Prandaj ne me kënaqësi ju kemi bashkëngjitur këtij aksioni me forca edhe me mbjellje po kontribuojmë dhe do vijojmë edhe më tej të kontribuojmë që ta bëjmë Tiranën sa më kreative të jetë më e këndshme, pse jo edhe për kalamajt tanë që do të jenë pjesë e jetës dhe e komunitetit", deklaroi kolonel Përparim Gega.



Drejtori i Agjencisë së Pareqeve dhe Rekreacionit në bashkinë e Tiranës, Admir Abrija vlerësoi kontributin e donatorëve të cilët bënë të mundur dhurimin e 2 mijë fidanëve dhe të efektivëve të Forcave të Armatosura për mbjelljen e tyre.

"Sot jemi duke mbjellur 2000 fidanë pishe të dhuruara nga 6 donatorë bashkë me ushtrinë që kemi bërë një punë të mrekullueshme për hapjen e gropave dhe vendosjen e pemëve po ecim përpara. Në këtë zonë kemi planifikuar që të mbjellim rreth 30 mijë fidanë të ndryshëm pishë, dafinë dhe ullinj. Sezoni po ecën shumë mirë dhe besoj që edhe me ndihmën e donatorëve të qytetarëve me projektin "Dhuro një pemë për qytetin" për Tiranën gjërat do të shkojnë shumë mire", tha Abrija.

Pylli Orbital, i njohur ndryshe edhe si unaza e 5-të e Tiranës, do të çojë në mbjelljen e një muri të gjelbër me 2 milionë pemë duke lidhur 14671 hektarë parqe, fusha bujqësore, pyje dhe forma të tjera të vegjetacionit rreth qytetit.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Gazetarë:
Saimir ALIJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ
Redaktore/Korrektore:
Anila DODA

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

“Ju na jepni forcë me buzëqeshjen tuaj”

Festa e fëmijëve në Garnizonin e Vaut të Dejës



Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, kanë zbritur më 26 dhjetor 2018, me të gjithë arsenalin e vet artistik në Garnizonin e Vaut të Dejës, për të festuar me fëmijët dhe prindërit e tyre ushtarakë në detyrë, festat e Krishtëlindjes dhe Viti të Ri.

Për të festuar kishin ardhur Zëvendës ministri i Mbrojtjes z.Petro Koçi, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Gjeneralbrigade Bardhyl Kollçaku, Komandanti i Forcave Tokësore Gjeneralmajor Nazmi Cahani, Komandanti i Garnizonit të Vaut të Dejës, kolonel Ali Mali, fëmijë të ushtarakëve, prindër, etj.

Ambjenti në të cilin u zhvillua aktiviteti, ishte dekoruar si për festë me zbukurime dhe drita shumëngjyrëshe, si dhe me një ekspozitë me punimet në pikturë, të fëmijëve të QKMBMM të FA. Por ai që ndezi festën dhe përfshiu të gjithë të pranishmit ishte programi i bukur artistik i përgatitur me kujdes dhe përkushtim nga Sektori i Kulturës dhe Sporteve të QKMBMM të FA. Tingujt dhe hareja, këngët e bukura, vallet e përgatitura për këtë rast dhe numërat e cirkut e bënë atmosferën edhe më tepër festive, ku u përfshinë së bashku dhe u bënë njësh, jo vetëm fëmijët e Qendrës të Kulturës por edhe ata të ushtarakëve të Vaut të Dejës.

Në garnizonin e Vaut të Dejës u recituan shumë poezi, u kënduan shumë këngë dhe u kërcyen shumë valle. Poezitë “Dritat e pemës” dhe “Porosia e Skënderbeut”, ishin ato që hapën festën dhe pastaj u vazhdua me këngët “Viti i ri”, “Shqipërisë i ngjaj”, “Santa Klaus po vjen në qytet”, etj. Grupi i baletit interpretoi “Kërcim modern” dhe vallen e Tropojës, por edhe atë Çamërisë, tinguj të bukur si nga jugu dhe veriu. Ndërsa Akrobatët e Cirkut Kombëtar përveç të tjerash interpretuan numëra shpejtësie që bënë të shkëlqenin sytë e vogëlushëve.

Komandanti i Garnizonit të Vaut të Dejës, kolonel Ali Mali, përshëndeti fëmijët dhe falenderoi organizatorët e “këtij aktiviteti kaq të bukur dhe mbresë lënës” siç tha ai. “Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA që ishin pranë fëmijëve të ushtarakëve të Vahut të Dejës me praninë e tyre, me tingujt me muzikën me vallet e bukura shqipëtare, që e bënë këtë festë kaq të hareshme dhe të dashur për fëmijët”. Por ai nuk la pa përmendur dhe përshëndetur edhe ushtarakët shqiptarë që shërbejnë në Afganistan në Misionin e Mbështetjes duke i uruar ata në veçanti dhe fëmijët e tyre me rastin e festave, “Gëzuar Krishtëlindjet dhe vitin e ri 2019!”, përfundoi ai.

Petro Koçi, zv/ministër i Mbrojtjes ju drejtua fëmijëve “të bukur e të mirë, pjesë e familjeve të ushtarakëve të Vaut të Dejës”. “Ne





shpesh harrojmë dhe nuk kuptojmë forcën e fëmijëve, por ata kanë forcën e pushtetit e të gëzimit të përditshëm dhe është detyra jonë t’i mbështesim ata”, tha ai. “Sa më të mirë të jeni ju”, ju drejtua ai fëmijëve të pranishëm në sallë, “aq më e mirë është Shqipëria dhe e ardhmja”. Në vazhdim z.Koçi iu përcolli fëmijëve një mesazh të ministres Olta Xhaçka. “Ju na jepni forcë me forcën e me buzëqeshjen tuaj”, nënvizon Xhaçka në përshëndetjen e saj dërguar pikërisht fëmijëve që festuan së bashku në Vaun e Dejës. Ndërkohë z.Koçi uroi për ditëlindjen ushtarakun Kiço Deçi, ditëlindje që përkonte me këtë festim të gëzuar.

Në fund “Babagjyshi” i vitit të ri “zbrazi” një thes me dhurata për të gjithë fëmijët e pranishëm në këtë festë dhe i uroi atyre një vit të begatë me sa më shumë suksese.

> ***Komandanti i Garnizonit të Vaut të Dejës, kolonel Ali Mali, përshëndeti fëmijët dhe falenderoi organizatorët e “këtij aktiviteti kaq të bukur dhe mbresë lënës” siç tha ai. “Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA që ishin pranë fëmijëve të ushtarakëve të Vahut të Dejës me praninë e tyre, me tingujt me muzikën me vallet e bukura shqipëtare, që e bënë këtë festë kaq të hareshme dhe të dashur për fëmijët”.***

Aktivitete për festat e fundvitit



Gjeneral Kollçaku me fëmijë e familjare të Policisë Ushtarake

Me rastin e festave të fundvitit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, mori pjesë ditën e hënë, më 24 dhjetor, në një takim festiv me fëmijët dhe familjet e ushtarakëve të Batalionit të Policisë Ushtarake.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe zëvendësministri i Mbrojtjes z.Petro Koçi, komandanti i Policisë Ushtarake kolonel Ekland Dauti, drejtori i J-9 në SHP kolonel Petrit Dajlani, kolonel Elton Reso, si dhe familjarët e ushtarakëve.

Gjeneral brigade Kollçaku, duke shprehur mirënjohje për realizimin e detyrës, sikur është bërë traditë në përmbylljen e vitit, ka ndarë këtë ditë me fëmijët e ushtarakëve, ku i përcolli së pari fëmijëve urimet më të mira për festat e fundvitit dhe mbarësi për vitin pasardhës dhe më pas urimet për të gjithë ushtarakët, familjet e tyre dhe personelin civil të Policisë Ushtarake.

Aktiviteti ka vijuar me një program me këngë, vjersha dhe valle të cilat përcollën tek të pranishmit emocione të veçanta.

Më tej, aktiviteti vazhdoi me shpërndarjen e dhuratave nga ana e zëvendësministri të Mbrojtjes z.Petro Koçi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku dhe komandantit të Policisë Ushtarake për fëmijët e ushtarakëve dhe civilëve të Policisë Ushtarake.

KREMTOHET 93 VJETORI I FORCËS DETARE SHQIPTARE

Detarët tanë kanë shkruar historinë e tyre të lavdishme

NGA SHEFQET KËRCELLI

Më datën 19 dhjetor 2018, në Komandën e Forcës Detare, Plepa, Durrës, u festua 93-vjetori i Krijimit të Flotës sonë Luftarake Detare. Në këtë festë të detarëve tanë morën pjesë krahas kuadrove dhe detarëve të Forcës Detare dhe ish-kuadro të Flotës Luftarake, veteranë të saj, që kanë shërbyer në vite, në anije dhe baza të rëndësishme të Flotës, për gjatë gjithë bregdetit shqiptar. Gjithashtu për të nderuar festën e detarëve dhe kontributin e tyre në vite, mori pjesë dhe Ministri i Mbrojtjes zonja Olta Xhaçka, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Gjeneralbrigade Bardhyl Kollcaku, ish-Presidenti Rexhep Mejdani, kuadro të Ministrisë së Mbrojtjes, familjarë të K/Admiral Abdi Mati, etj.

Mbas ekzekutimit të Hymnit Kombëtar, Komandanti i Forcës Detare, Gjeneralmajor YlberDogjani, duke përshëndetur pjesmarrësit e kësaj ceremonie falenderoi përprezencën e tyre në këtë ceremoni, "duke u bërë pjesë e familjes sonë të madhe, të detarëve, që sot festojnë 93 vjet histori, krenari, angazhim dhe sakrifica në mbrojtje të atdheut tone të dashur".

Bashkë me festën e Forcës Detare, u kremtua dhe 100 vjetori i lindjes së K/Admiralit Abdi Mati i cili me "28 vite në shërbim të Forcës Detare, 24 prej të cilëve në krye të saj është kthyer në një legjendë të pa kontestueshme që kujtohet me respekt nga kolegët dhe bashkëpunëtorët e tij, ndaj në vijim të fjalës së tij, Gjeneral Dogjani tha se: "është nder dhe krenari për mua të mirëpres, Ju familjarë të Admiral Abdi Matit, ish drejtues në vite të Forcës Detare, miq dhe shokë, për të festuar ditën e krijimit dhe për të nderuar së bashku, Admiral Abdi Matin, këtë emër të lidhur pazgjidhshmërisht me Forcën Detare. Admiral Abdi Mati la pas një flotë detare të mire organizuar, të aftë për tju përgjigjur kërkesave të kohës, ndaj sot ne kemi një Forcë Detare që po modernizohet me pajisje dhe mjete moderne, kemi një trupë oficerësh të trajnuar dhe kualifikuar në vendet perëndimore, kemi anije të klasit "Iliria", të cilat prej dy vjetësh janë pjesë e NATO-s, duke shpëtuar jetë në detin Egje, kemi oficerë që shërbejnë në Komandat dhe shtabet e NATO-s, duke na përfaqësuar denjësisht. Unë besoj se Admiral Abdi Mati, do ishte krenar me ne sot", nënvizoi GjeneralDogjani.

Më pas të pranishmit i përshëndeti dhe zoti Tasim Meçe, ish drejtues i Flotës sonë Luftarake, i cili evidentoi rolin e K/Admiral Abdi Matit, në ringritjen dhe transformimin e Flotës Luftarake. "K/Admiral Abdi Mati, ishte një ushtarak me cilësi të rralla dhe i përkushtuar për zbatimin e detyrave. Ai me paraqitjen e tij të impononte respekt, simbol i një kuadri dinjitoz, mësues dhe drejtues i talentuar. Ai mbetet trashëgëmia që vazhdon të frymëzojë edhe sot, kuadro e detarë të Forcës Detare", theksoizotiMece.

Në këtë date të shënuar për Forcën Detare, pjesmarrësit i përshëndeti dhe zoti Zamir Mati, djali i K/Admiral Abdi Matit. Ai falenderoi Ministrinë e Mbrojtjes, Komandën e Forcës Detare dhe kuadrot detarë për vlerësimin e respektin që i kanë bërë figures së babait të tij, si një nga ish drejtuesit më të rëndësishëm të Flotës sonë Luftarake, me kontribut të veçantë në ringritjen dhe zhvillimin e Flotës sonë Luftarake.

Ndërkohë Ministri i Mbrojtjes Olta Xhaçka, në përshëndetjen drejtuar detarëve theksoi se, "mundi, sakrificat dhe vështirësitë e kaluara në qindra lundrime, stërvitje apo operacione në hapësirën tone detare nuk harrohen kurrë nga populli ynë dhe do përcillen nga brezi në brez. Në çdo periudhë, epokë apo ngjarje historike, roli i detarëve shqiptarë në Adriatik e Jon, ka qenë prezent, për vetë pozicionin gjeografik të vendit tonë. Sigurisht, në



këtë histori të ndritur, periudha mbas krijimit të shtetit shqiptar zë vend kryesor. Gjatë kësaj rruge shekullore, ku bashkohet kontributi i disa brezave, përfshihet dhe roli i pazëvëndësueshëm i detarëve me uniformë, të cilët në vite, me sakrifica, vështirësi, guxim e heroizëm, duke u përballur me dallgët e detit, gjatë lundrimeve pa fund, ditë e natë, në mot të qetë e të trazuar, kanë shkruar historinë e tyre të lavdishme, si pjesë integrale e Historisë së Popullit Shqiptar".

Në vazhdim ministrja Xhaçka tha se: "Flota jonë Luftarake Detare, në këto 93 vite ka pasur zhvillime të rëndësishme në varësi të strategjisë dhe politikave të sigurisë të ndjekura nga shteti ynë. Efektivat e Flotës sonë Luftarake Detare, në këto 93 vite janë dalluar për profesionalizmin, kulturën, vullnetin e përkushtimin në kryerjen e misionit fisnik për mbrojtjen e kufijve dhe zbatimin e ligjshmërisë detare, duke bashkëvepruar me strukturat e tjera të shtetit shqiptar. Detarët tanë shkruan me mund, djersë, gjak e sakrifica të panumurta, historinë e ndritur të Forcës Detare Shqiptare".

Ajo gjithashtu bëri të ditur se falë profesionalizimit të treguar nga efektivët shqiptarë në 24 muajt e operacionit të NATO-s "Sea Guardian", misioni do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2019.

"Tashmë u mbushën dy vjet që nga fillimi i këtij misioni jo të lehtë dhe prezenca jonë atje është tepër e vlerësuar dhe e kërkuar nga drejtuesit e operacionit. Marinarët tanë janë kthyer në heronj dhe kanë shpëtuar mijëra jetë njerëzish nga mbytja e sigurt në det. Ne jemi të vendosur që të vijojmë edhe vitin që vjen do të jemi sërish prezent në këtë rajon, së bashku me Aleatët tanë", - nënvizoi ministrja e Mbrojtjes.

"Gjithashtu detarët tanë kanë pasur dhe kanë një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe mbrojtjen e hapësirës sonë detare, si një burim i rëndësishëm për ekonominë e vendit tonë. Hapësira jonë detare ka marë rëndësi të veçantë gjatë kësaj periudhe dhe për shkak të zbatimit të projektit TAP", theksoi ajo.

Në fund të fjalës së saj Ministrja ka uruar përzëmërsisht: Gëzuar 93 vjetorin, ditën e krijimit të Forcës Detare!

Në vijim pjesmarrësit vizituan një fotoekspozitë të përgatitur enkas për këtë ceremoni me tematikë: "Forca Detare në vite dhe jetën e K/admiral Abdi Matit". Ndërkohë zoti Zamir Mati, djali i madh i K/Admiral Abdi Matit prezantoi një album, me fotografi, "Flota Shqiptare, 1945-1992". Takimi u mbyll me një fotografi të përbashkët.

Theksojmë se data 25 dhjetor 1925, u caktua si dita e krijimit të Flotës Luftar-

ake, në një Vendim të Qeverisë Meksi, në Korrik të vitit 1992. Kjo erdhi si rezultat i një punë kërkimore, hulumtuese dhe shkencore në arkivat e shtetit shqiptar nga kryesia e Historianëve Ushtarakë, nën drejtimin e të ndjerit. Prof. Dr. Gjergj Titani. Pjesë e këtij komisioni ishteedhe autori i këtij shkrimi, ku ne si grup, me kujdes, bazuar në dokumenta autentike, propozuam të gjitha Festat e Forcave, Armëve e Shërbimeve, të shtrira në afate kohore që nga themelimi i Ushtrisë Shqiptare më 4 dhjetor 1912.

Në përkujtim të këtij jubileu të detarëve shqiptarë, le të hedhim një vështrim të shkurtër të historisë së Flotës sonë Luftarake, bashkë me lexuesit tanë.

Nga "Elco-ot" Amerikanë të Luftës së I-re Botërore, tek "ARChangel-at" e 2010, Dhuratë e Departamentit të Shtetit të SHBA

Në arkivat e Mbretit Zog shkruhet se, më 24.06.1928, u krijua Komanda e Marinës në Durrës, me komandant, kapidan Ahmet Kapidani, dhe u mblodhën rekrutët e parë për këtë armë. Po këtë vit në bazë të një marrëveshje ndërmjet qeverisë së asaj kohe dhe qeverisë italiane u sollën nga Venecia 5 (pesë) MV "Antisomergibile" të tipit "Elco" Amerikan, të cilat ishin përdorur gjatë Luftës së I-rë Botërore. Gjatë periudhës së Luftës së 2-të Botërore, pothuajse u rrënua gjithçka nga këto anije. Ndaj, çlirimi i vendit e gjeti Flotën Shqiptare në gjendje të mjerueshme, me pothuajse të gjitha anijet të mbytura në portet, bregdetin shqiptar, italian dhe dalmat. Ndërkohë fillimi i vitit 1945, shënoi përpjekjet e para për riorganizimin dhe ringritjen e Forcave Detare. Kështu më 23 shkurt 1945, pranë Komandës së Përgjithshme të UNÇLSH, u krijua Seksioni i Marinës Luftarake me shef seksioni, Kapiten i 1-rë, Abdi Mati.

Nga dokumentacioni i kësaj komande vlejnë për tu përmendur urdhërat për thirrjen e oficerëve të marinës në detyrë, urdhër nr.44. dt.30.03.45, për riorganizimin e kantiereve të riparimit dhe funksionimin e kapitenerive të porteve nën kujdestarinë e seksionit të marinës, urdhëri nr.82. dt.04.05, "Për rikthimin e barkave shqiptare që ndodheshin në Itali", etj.

Më 15 gusht 1945, u bë përurimi i hedhjes në ujë të dy motoskafeve trofe me numër MS-10 dhe MS-12. Këto motoskafë u armatosën me mitraloz të lehtë dhe filluan patrullimin në ujërat tona bregdetare.Mbas viteve 60, u shënua fillimi i një etape të re zhvillimi të FLD, me pajisjen e tyre me silurhedhës e më vonë me Minaheqëse, Gjuajtësa Detarë, Nëndetëse dhe anije ndihmuese të llojeve të ndryshme. Për këtë u shfrytëzuan edhe konjukturat politike të kohës. Bëhet fjalë për lidhjet e bashkëpunimin në shumë fusha me vendet e ishkampit socialist, që i shërbyen dhe strategjisë e gjeopolitikës të këtij kampi.

Mbas viteve 90, me mbështetjen e partnerëve tanë te NATO-s, veçmas SHBA, si dhe nën kujdesin e qeverisë dhe popullit shqiptar, Forca Detare ka bërë hapa para për realizimin e misionit kushtetues, mbrojtjen dhe zbatimin e ligjshmërise detare, mbajtjen në kontroll të kësaj hapësire nëpërmjet Sistemit të Ri të Vëzhgimit të saj si dhe krijimin e kapaciteteve te nevojshme operacionale për planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve humanitare në ndihmë të komunitetit. Duke mbajtur një prezencë të përhershme dhe aktive në det, Forca Detare është tashmë një aktor i rëndësishëm dhe i vlerësuar nga opinioni, shteti shqiptar dhe partnerët tanë. Ndërkohë anëtarësimi i vendit tonë në NATO, solli nevojën e një teknologjie ndërvepruese e efikase me partnerët e FD dhe hartimin e një plani modernizimi racional, mbështetur në burimet ekonomike që afronte shteti shqiptar.

Ky plan transformimi përfshiu modernizimin e FD me sisteme, pajisje e mjete detare, të shtrira në plane afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, ku prioritet ka qenë kompletimi me mjete të reja që kryejnë misionin e Rojes Bregdetare. Në dekadën e fundit pajisja e FD me katër anije patrulluese të mëdha, në kuadër të zbatimit të kontratës me Kompaninë Hollandeze "Damen Shipyards"; me Motovedeta të shpejta "Archangel", Dhuratë e Departamentit të Mbrojtjes së SHBA dhe anije antindotje që u blenë në Itali, ndërtimi i Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare nga firma prestigjioze Amerikane "Lockheed-Martin", pajisja me sisteme të vëzhgimit natën dhe sistemin AIS të anijeve të Rojes Bregdetare, përmirësimet infrastrukturore të vendbazimeve detare, etj. janë hapa konkretë në zbatim të këtyre politikave zhvillimore të Forcës Detare. Në këtë kuadër projekti më i rëndësishëm për modernizimin e FD, ishte nënshkrimi më 13 nëntor 2007, i marëveshjes për pajisjen e FD me 4 anije Patrulluese STAN PETROL-4207. Ky projekt bëri të mundur që 6 vjet më parë më 5 Shtator 2008, në molin Nr.5 të Portit të Durrësit të bregëzohet anija "Iliria", (P-131), një trashëgimtare e denjë e "Liburnes" dhe "Lembes" ilire. Në vijim më 14 Maj 2009, filloi ndërtimi i anijes "Oriku", (P-132), e cila u lëshua në ujë më 13 shtator 2011 dhe më 3 dhjetor 2012 u lëshua në ujë anija e tretë, (P-133) "Lissus". Ndërkohë më 8 prill 2014 u lëshua në ujë anija e katërt, "Butrinti" (P-134), që shënoi dhe përfundimin e këtij projekti.

Modernizimi i FD me pajisje, sisteme dhe anije për të zëvendësuar teknikën e vjetër me teknikë moderne e bashkëkohore, të ndërvepruesme me NATO-n, me qëllim rritjen e kapaciteteve operacionale për realizimin e misionit dhe detyrave të përcaktuara në ligj, janë hapa konkretë në zbatim të këtyre politikave zhvillimore e transformuese të këtyre viteve të fundit.

Theksojmë se historikisht, përbërja, struktura dhe mjetet që kanë pasur në dispozicion Forcat Detare kanë ecur paralel me zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit dhe mundësitë financiare të shtetit shqiptar, një mbështetje e cila ka qenë e vazhdueshme në këto 93 vite të ekzistencës. Krahas modernizimit është punuar për arësimimin dhe kualifikimin e kuadrove e personelit të anijeve si brenda dhe jashtë vendit. Gjatë këtyre 28 viteve, vetëm në SHBA, janë kualifikuar në shkolla dhe akademi të ndryshme detariembi 100 kuadro detarë të rangjeve të ndryshme, me një kosto miliona dollarë.

Sigurisht që anëtarësimi i vendit tonë në NATO, e bëri evident ndryshimin dhe reformimin e Forcës Detare, përmirësimin e legjislacionit detar, konsolidimin e strukturave, modernizmin dhe pajisjen me mjete të kohës, etj.

Forca jonë Detare ka pasur një bashkëpunim të frutshëm me Komandën e Komponentit Detar të NATO-s në Napoli dhe Northwod, Angli, me Flotën e 6-të të SHBA në Mesdhe si dhe me Flotat partnere të vendeve anëtare të NATO-s, duke zhvilluar projekte të rëndësishme që kanë shtuar aftësitë dhe kapacitetet e tjera opracionale. Në këto vite FD ka bërë hapa para në realizimin e misionit kushtetues, mbrojtjen dhe zbatimin e ligjshmërise detare, mbajtjen në kontroll të kësaj hapësire nëpërmjet Sistemit të ri të Vëzhgimit të Hapësirës sonë ujore dhe zhvillimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit. Zhvillimi e transformimi, kjo është simbolika e Forcës sonë Detare në këtë 93 vjetor.

Është fakt që ky përvjetor i 93-të i gjen Forcat Detare më të afta, më të pjekura dhe të maturuara, me një personel të motivuar e të aftë profesionalisht, me mjete të reja dhe infrastrukturë moderne. Zhvillimi dhe transformimi është karakteristikë kryesore e Forcës sonë Detare, e cila tashmë është një partnere denjë e Flotave të NATO-s.Vetëm gjatë këtyre viteve të fundit, efektivat tona kanë zhvilluar një sërë stërvitjesh të përbashkëta me vendet e NATO-s, brenda dhe jashtë vendit si: "Adriatik-Phiblex", "Adrijon-Livex", "Albanian-Lion", si dhe ato për zbatimin e ligjshmërisë detare dhe SAR, në bashkëpunim me Forcat e tjera të Ushtrisë dhe Institucionet tona detare si "Durrës-SAR-Ex", "Vlora-SAR-Ex", "Shqiponja e Lumtur", "Delfini", "Imponimi", "Joni", etj. Spikat ne keto vite, pjesmarrja e detareve tane ne operacionin "Sea Guardian", ne Detin Mesdhe, ku detaret tane kane kryer disa operacione humanitare. Moto e detarëve tanë është, gatishmëri, aksion, prezencë dhe kontroll të hapësirës sonë detare gjatë gjithë kohës. Nën këtë moto ekuipazhet e anijeve të gatshme në vite kanë zhvilluar një sërë operacionesh humanitare nga jugu në veri, duke u vlerësuar nga opinioni dhe komuniteti ynë. Në zhvillimin e këtyre operacioneve Forca Detare bashkëpunon ngushtësisht me institucionet e tjera detare me interesa në det, si Kapiteneria e porteve, Policia Kufitare, Antikontrabanda Detare, Inspektoriati i peshkimit, Inspektoriati i mjedisit, Delta Forc, etj, në kuadër të QNOD. {Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare}. Natyrisht personeli i kësaj Force është i ndërgjegjshëm se në të ardhmen ka plot sfida e detyra konkrete, që kanë të bëjnë me transformimin dhe modernizimin e Forcës Detare si dhe monitorimin efikas të situatës detare, për të cilat detarët tanë kanë paracaktuar vizionin, objektivat e synime të qarta.

Shënim: Historinë e plotë të Forcës Detare Shqiptare e gjeni tek "Antologjia e Detarisë Shqiptare", vëllimi i 2-të dhe i 3-të.Kapitulli per Forcen Detare, ish Flota Luftarake.

Forca Tokësore

Medalja "Repart i Shquar" për Batalionin e Dytë të Këmbësorisë

Batalioni i Dytë i Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b2kFT), u dekorua më 24 dhjejtor 2018 me medaljen "Repart i Shquar". Kjo medalje e akorduar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, iu dorëzua këtij reparti gjatë ceremonisë së zhvilluar me këtë rast.

Në ceremoni merrnin pjesë: shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcës Tokësore gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Nazmi Cahani, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm kolonel Petrit Çuni, komandanti i b2kFT kolonel Arjan Hilaj, komandantë repartesh vartëse të FT, si shefat Degëve të Shtabit të FT.

Ceremoninë e hapi komandanti i b2kFT kolonel Hilaj, i cili e vlerësoi nderimin që i bëhet repartit që ai drejton si një një moment i veçantë për të gjithë, pasi ky moment rastis me vitin mbarëkombëtar të Skënderbeut si dhe me festat e fundvitit. Më tej duke bërë një përmbledhje të sfidave stërvitjeve dhe vlerësimeve që b2kFT, ka kaluar ndër vite kolonel Hilaj do të shprehej: "… jemi krenarë për arritjen tonë, pasi ia arritëm të përmbushim një objektiv kombëtar si njësia e vetme, e cila ndër vite ka kaluar një sërë vlerësimesh certifikimesh dhe sfidash deri në momentin e certifikimit si Grup-Batalion i Këmbësorisë së Lehtë. "Gjatë fjalës së tij, ai falënderoi ministren e Mbrojtjes për mbështetjen e vazhdueshme të saj për këtë repart, çka, sipas kolonel Hilaj, është tregues i qartë i vëmendjes së saj dhe të qeverisë shqiptare ndaj ushtarakëve të b2k.

Duke falënderuar gjithashtu edhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku si dhe komandantin e Forcës Tokësore gjeneralmajor Nazmi Cahani, për mbështetjen e pandërprerë në interes të realizimit të çdo misioni dhe detyre për b2kFT, komandanti i b2k kolonel Arjan Hilaj i siguroi ata se ky repart do të jetë gjithmonë në lartësinë e detyrës për realizimin e çdo objektivi të kërkuar.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku duke përshëndetur ceremoninë ndër të tjera u shpreh: "… kjo medalje sot shkon për të gjithë ju nga kolonel Hilaj, deri tek ushtari i fundit. Është një nderim që ju e keni fituar me djersë, vetëmohim dhe sakrifica përgjatë gjithë këtij viti kalendarik. Shtabi i Përgjithshëm dhe FT ka qenë pranë jush gjatë gjithë stërvitjeve tuaja të këtij viti, që nga "Fekeni -18" në muajinjanar e deri te stërvitja "Biza-18" në fund të shtatorit. Por, kjo është detyra jonë, është më e pakta që mund të kishim bërë për ju, sepse ju sakrifikuat, luftuat fort të gjithë këtë periudhë dhe merituat të jeni njësia e parë Combat Ready sipas kapaciteteve të NATO për GBKL. Ky ishte një objektiv kombëtar, që mund të realizohej vetëm nga djem dhe vajza si ju. Në sytë tuaj, unë shikoj përkushtim, disiplinë sakrificë dhe ju me të vërtetë që e meritoni. Ta gëzoni këtë medalje! MM dhe SHPFA do të vazhdojë t'ju mbishtesë për të ruajtur këtë nivel gatishmërie, por edhe për të na përfaqësuar në të gjitha sfidat që ne do të kemi qoftë jashtë vendit në kuadër të NATO, po ashtu edhe sfidat që kemi brenda vendit për përballimin e sfidave të Emergjencave Civile. Ne jemi të sigurt, që me djem dhe vajza si ju, çdo detyrë do të përballohet me sukses …"





Në përfundim të fjalës së tij gjeneral brigade Kollçaku, u uroi të gjithë të pranishmëve gëzuar Festat e Fundvitit. Dekorimi i Batalionit të Dytë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore, u krye më motivacionin "Për trimëri e vendosmëri të lartë, gjatë përmbushjes së misionit përmes vështirësive të mëdha". Ky dekorim, është një vlerësim i madh dhe i merituar, që i bëhet këtij reparti elitë dhe prioritar të Forcave të Armatosura.

FORCA AJRORE: ANALIZA PËR 2018-TËN DHE OBJEKTIVAT 2019

Stërvitjet ajrore sipas standardeve të NATO-s

Forca Ajrore Shqiptare, si strukturë përbërëse e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2018, ka realizuar me përgjegjësi dhe profesionalizëm të gjitha detyrat e ngarkuara që rrjedhin nga Direktiva e Ministrit të Mbrojtjes dhe misioni i kësaj Force.

Për një analizim të këtyre realizimeve, por edhe problematikave të hasura gjatë vitit, më datën 21 dhjetor 2018, në Komandën e Forcës Ajrore u zhvillua analiza e realizimit të objektivave dhe detyrave kryesore të planizuara për vitin 2018.

Analiza u drejtua nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Flamur Hadushi, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshem të FA, komandantëve të reparteve dhe shefave të degëve në Shtabin e Forcës Ajrore.

Gjatë analizës u trajtua puna e bërë për realizimin e detyrave të vëna, treguesit kryesorë që janë arritur gjatë këtij viti, si dhe u përcaktuan synimet dhe objektivat kryesore për vitin e ardhshëm. Gjithashtu u evidentuan edhe vështirësitë e hasura në rrugën e përmbushjes së misionit dhe realizimit të detyrave.



Nga të pranishmit u diskutua për problemet e dala në realizimin e detyrave të vëna, si dhe për rrugën e zgjidhjes së tyre.Në përfundim të analizës zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Flamur Hadushi vlerësoi punën e personelit të Forcës Ajrore në përmbushjen e detyrave të tyre, duke u shprehur se pavarësisht arritjeve të deritanishme dhe profesionalizmit të treguar në mbështetje të realizimit të misionit dhe detyrave të Forcës Ajrore, mbetet si prioritet dhe domosdoshmëri përmbushja e objektivave të kapaciteteve për vitin 2019. Gjatë vitit 2019, rëndësi e veçantë do ti jepet rritjes së shkallës së gatishmërisë dhe të operacionalitetit në strukturat operacionale të Forcës Ajrore, vazhdimi e procedrave per zbatimin e projektit për SIVHA, trajnimi i personelit operator të QKR dhe realizimi i praktikave "On Job Training", zhvillimi i stërvitjes ajrore sipas standardeve të kërkuara, pjesëmarrje dhe rritje e shkallës së bashkëpunimit dhe ndërveprueshmërisë në stërvitje të përbashkëta me NATO-n, etj.

3.5 miliardë USD për 80 raketa Patriot MIM-104E dhe 60 raketa Patriot-3

SHBA miraton shitjen e sistemeve Patriot për Turqinë

Departamenti Amerikan i Shtetit ka miratuar shitjen e sistemit Patriot për Turqinë për mbrojtje ajrore dhe për mbrojtje nga raketat në vlerë prej 3.5 miliardë dollarë.

Agjencia për Bashkëpunimin e Mbrojtjes së Sigurisë e lidhur me Departamentin Amerikan të Mbrojtjes (Pentagon), ka bërë një deklaratë me shkrim lidhur me miratimin e shitjes.

Në deklaratë thuhet se "Departamenti miratoi shitjen në vlerë prej 3.5 miliardë dollarë të 80 raketave të avancuara udhëzuese Patriot MIM-104E, të 60 raketave Patriot-3 (PAC-3) me aftësi të përparuara si dhe të pajisjeve përkatëse. Agjencia për Bashkëpunimin e Mbrojtjes së Sigurisë më 18 dhjetor ka informuar Kongresin në lidhje me çështjen e shitjes".

Përveç kësaj, në paketën e sistemit të mbrojtjes, krahas 4 grupeve të radarëve AN/MQP-65, 4 sistemeve të kontrollit të bllokimit, 10 grupeve të antenave direkte, 20 stacioneve lëshuese M903, 5 centraleve elektrike, në paketë përfshihen edhe pajisje komunikimi, pajisje testimi, programe të distancës dhe pajisje mbështetëse.

Më tej thuhet se miratimi i shitjes, do t'i shtojë fleksibilitet të konsiderueshëm kapacitetit të mbrojtjes ajrore të Turqisë. "Një Turqi e sigurtë me aftësinë e parandalimit të kërcënimeve ajrore dhe raketore si dhe të sulmeve të tjera, do të sigurojë paqe dhe stabilitet në NATO dhe kontinentin e Evropës", theksohet në deklaratë.

Një zyrtar i Departamentit Amerikan të Shtetit në një deklaratë me shkrim për gazetarin e AA-së në lidhje me çështjen ka thënë se "Kjo shitje e propozuar do të rrisë sigurinë e aleatëve të NATO-s, do të kontribuojë për mbrojtjen e aleatëve dhe partnerëve nga kërcënimet ajrore dhe raketore si dhe do të kontribojë në politikën e jashtme dhe sigurinë kombëtare të



SHBA-ve".

"Turqia do të përdorë sitemin Patriot për të përmirësuar aftësitë e mbrojtjes ajrore dhe të raketave, për të mbrojtur integritetin territorial dhe për të parandaluar kërcënimet rajonale. Kjo shitje e propozuar do të rritë aftësitë e ushtrisë turke për t'u mbrojtur nga sulmet armiqësore si dhe për mbrojtjen e aleatëve të NATO-s që ndodhen brenda Turqisë", ka theksuar zyrtari i Departamentit të Shtetit.

Ndërkohë Turqia ka një marrëveshje për të blerë nga Rusia sistemin rus të mbrojtjes S-400. Po a do të ndikojë marrëveshja me amerikanët për blerjen e raketave Patriot? Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, deklaroi më 19 dhjejtor se miratimi për shitjen e sistemeve amerikane Patriot për Turqinë nuk ka lidhje me procesin e shitjes së sistemit rus S-400 dhe zbatimin e vazhdueshëm të kësaj marrëveshjeje, transmeton Anadolu Agency (AA). "Aktualisht po zbatojmë marrëveshjen me kolegët tanë turq. Projekti dhe marrëveshja S-400 janë në proces të zbatimit dhe kjo do të vazhdojë", tha në një deklaratë për gazetarët Peskov. Ai theksoi përsëri se procesi për shtijen e sistemeve amerikane Patriot për Turqinë nuk ka lidhje me procesin e shitjes së sistemit rus të mbrojtjes ajrore S-400 dhe zbatimin e vazhdueshëm të kësaj marrëveshjeje.

Pentagoni do të krijojë "Komandën Hapësinore"

SHBA-ja do të krijojë një komandë të re hapësinore pas urdhrit të presidentit Donald Trump për të mbikëqyrur operacionet ushtarake të vendit në hapësirë.Në bërjen e kësaj deklarate, zv.presidenti Mike Pence e quajti atë si zanafillën e një epoke të re të udhëheqjes amerikane në hapësirë.Komanda e 11-të luftarake e Pentagon-it do të mbikëqyrë të gjitha veprimtaritë ushtarake amerikane në hapësirë dhe të pritet që të shpenzojë 800 milionë dollarë amerikane në 5 vitet e ardhme.



Ky është një hap i madh në planin e Trump-it për të ndërtuar një "Forcë Hapësinore" të pavarur deri në vitin 2020, që ka shkaktuar shqetësimet mbi shtimin e kostos dhe burokracisë. Ushtria e ShBA-së kishte një Komandë Hapësinore nga viti 1985 deri në vitin 2002, por ajo u shpërbë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, prandaj u krijua Komanda Veriore e ShBA-së, e cila fokusohet tek mbrojtja kombëtare.



QEVERIA JAPONEZE PËR USHTRINË

Shpenzime rekord: 24.3 miliardë USD deri në vitin 2024

Japonia është e gatshme të vendosë transportuesit e saj të parë të avionëve në det që nga Lufta e Dytë Botërore.Ajo do rimarrë anijet luftarake të saj Izumo për të transportuar avionët luftarakë F-35B të dizenjuar në SHBA.Tokio tha se do blejë 42 nga F-35B, që janë të dizajnuara për ngritje afatshkurtra dhe ulje vertikale."Qeveria do të marrë të gjitha masat e mundshme për të mbrojtur jetët dhe pasuritë e popullit japonez,"- tha Sekretari i Kabinetit, Yoshihide Suga të marten që kaloi, pas mbledhjes së kabinetit ku u miratua program i ri për vetëmbrojtën dhe plani i përgatitjes së forcave mbrojtëse afatmesme, duke përfshirë krijimin e sistemit të vetëmbrotjes ndër-rajonale, aeroplanmbajtëset, blerjen e pajisjeve të reja në përmasë të madhe etj. Njoftimi është pjesë e një plani të ri pesëvjeçar të mbrojtjes, miratuar nga qeveria e kryeministrit Shinzo Abe, që do bëjë gjatë 5 viteve të ardhshme, shpenzime rekord në ushtri prej 24.3 miliardë dollarë deri në mars të vitit 2024, me një rritje 10 përqind.Kjo shifër do të shënojë një rekord të ri të buxhetit 5 vjeçar të mbrojtjes të Japonisë.

Holanda do të blejë 15 avionë luftarakë F-35

Holanda parashikon blerjen e 15 aeroplanëve të rinj gjuajtës F-35 të prodhuesit amerikan në fushën e aeronautikës "Lockheed Martin", përveç kontigjentit të 37 avionëve të porositura më parë. Dorëzimi i tyre parashikohet për vitin e ardhshëm, njoftoi ministrja e Mbrojtjes, Ank Bijleveld."Qeveria holandeze aspiron të blejë rreth 15 avionë shtesë F-35", deklaroi ministrja për agjencinë holandeze të lajmeve "ANP", duke shtuar se ajo i kishte dërguar një letër NATO-s në këtë drejtim. Në tërësi, Holanda është angazhuar të investojë më shumë në fushën e mbrojtjes gjatë vitit të ardhshëm për të përmirësuar kapacitetin e saj ushtarak.

NASA zbulon një asteroik poshtë akujve

Një asteroid metalik, prej 1 500 metrash diametër, goditi Tokën 2,5 milionë vite më parë, shkruan gazeta italiane ''Corriere della Sera''.

Edhe pse në mënyrë të konsiderueshme më i vogël se pasojat që kanë kontribuar në zhdukjen e dinosaurëve 65 milion vjet më parë, asteroidi ishte i barasvlefshëm me 47 000 bomba atomike si ajo e lëshuar në Hiroshimë dhe ndoshta përcaktoi "përçarje" të klimës në nivel global.

Ai formoi një krater 300 metra të thellë dhe me një diametër prej 31 kilometrash, të krahasueshëm me atë të një qyteti si Roma.

Tani ai është i mbuluar nga një shtresë akulli 1.000 metra e lartë. Asteroidi është zbuluar në një zonë të largët të Groenlandës Veriperëndimore nga operacioni "IceBridge" i NASA-s falë survejimit të radarëve në një avion të specializuar. Zbulimi u bë në vitin 2015, por shkencëtarëve iu deshën tre vjet para se të bënin një kontroll.



Akademia e Forcave të Armatosura

Çfarë është Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (SCSDS)

Më propozim të Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin përkatës më datë 12.12.2018



Akademia e Forcave të Armatosura Shqiptare është një institucion i arsimit të lartë, i akredituar nga Agjencia Shqiptare për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë të Mbretërisë së Bashkuar.

Në shtator 2007, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Shqiptare, në kuadër të bashkëpunimit rajonal, vendosën për të hapur për herë të parë Kursin e Lartë për Studime të Sigurisë dhe Mbrojtjes (SCSDS). Si një trend pozitiv i bashkëpunimit ky kurs u zhvillua në anglisht duke mirëpritur pjesëmarrjen nga vendet e rajonit dhe më gjerë.

Që nga 1 Nëntori 2012 Kurs i Lartë për Sigurinë dhe Studimet e Mbrojtjes (SCSDS) është një kurs i listës së NATO-s, bazuar në Bi-SC D 75-7 (Udhëzimi për Trajnim i Edukimit dhe Trajnimit të NATO-s), maj 2009 me Amendamentin Korrik 2010.Kursi është 13 javë, me një javë pune nga e hëna deri të premten.

Ky kurs zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura Shqiptare në Komandën e Trajnimit dhe Doktrinës (TRADOC) për një periudhë prej tre muajsh për oficerë ushtarakë dhe civilë me përvojë në çështjet që lidhen me sigurinë dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.Qëllimi i kursit është jo vetëm për të zgjeruar kapacitetet intelektuale të pjesëmarrësve, por gjithashtu siguroi një mjedis të shëndetshëm dhe vazhdimësi të një bashkëpunimi të tillë dhe mirëkuptim të përbashkët në të gjithë rajonin.

Komandantët e njësive vartëse prezantuan situatën për menaxhimin e personelit, të forcave të mbrojtjes, operacioneve, trajnimeve dhe stërvitjeve, logjistikës, komunikimit e lidhjeve, buxhetimit dhe marrëdhëniet civile-ushtarake. Kështu u theksua se është realizuar përmbushja e detyrave të planifikuara, rezultatet e arritura në trajnim dhe angazhimet, kushtet e jetës dhe të punës, si dhe mësimet e nxjerra nga misionet paqeruajtëse.

Nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm në fund të konkluzioneve u deklarua për kushtet e paraqitura dhe u dhanë udhëzime mbi aktivitetet e planifikuara për viti 2019.

Nënshkruhet marrëveshja

14 mijë komplete uniformash për pjestarët e ARM-së

Ministria e Mbrojtjes nënshkroi një kontratë për prokurimin e 14,000 kompleteve të uniformave ushtarake në terren për nevojat e pjesëtarëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë, që deri më tani është prokurimi i parë i nga dy kompleteve të uniformave për secilin pjesëtar të ARM-së.

Shuma e kontratës e nënshkruar me kompaninë nga "Dona-M" përmes një procedure publike dhe transparente të prokurimit publik të paraprirë nga një dialog teknik me kompanitë e interesuara është në vlerë prej 54.5 milion denarë me TVSH të llogaritur, ndërsa sasia totale e kompleteve uniformave ushtarake-teren duhet të dorëzohet deri në fund të marsit të vitit të ardhshëm.

Herën e fundit janë blerë 5,000 uniforma për pjesëtarët e Ushtrisë në vitin 2013 dhe 1,100 uniforma në vitin 2017. Kontrata u lidh këtë muaj për 14,000 komplete të uniformave ushtarake për terren, dhe është heras e parë që të sigurohen për pjesëtarët e ARM-së me dy complete uniformash.

Ministrja Shekerinska ka informuar vazhdimisht publikun se për Ministrinë janë prioritet prokurimet që ndikojnë drejtpërdrejt në kushtet e ARM-së për punë dhe jetë. Në fillim të tetorit, ministrja informoi se ka nënshkruar një marrëveshje për blerjen e rreth 7,200 palë çizmesh për ARM-në prej të cilave 4,350 tashmë janë dorëzuar dhe pjesa tjetër pritet të dorëzohet javën e ardhshme. Pasi të kryhet kontrolli i cilësisë dhe testet eventuale laboratorike në një laborator të akredituar, çizmet do t'ju shpërndahen ushtarëve.Herën e fundit, çizme ushtarake për pjesëtarët e ushtrisë janë blerë në vitin 2012 dhe 2013, por edhe atëherë në numër të pamjaftueshëm për të gjithë pjesëtarët e ARM-së.

> “Marrëveshja për furniziminme uniforma detare është zbatuar me sukses gjatë vitit aktual, por ka një plan të përcaktuar për blerje të uniformave të reja për pilotët edhe në vitin e ardhshëm”, tha ministri, duke shtuar se kjo është vetëm një segment i modernizimit të Ushtrisë së Malit të Zi.



Ministri Boskovic u takua atasheun turk Sakir Somer

Turqia-një aleat i besueshëm për Ushtrinë e Malit të Zi

Ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi, Predrag Boskovic, u takua 20 dhjetor me atasheun e sapoemëruar të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës të Turqisë, kolonel Sakir Somer dhe atasheun ushtarak turk i cili do të largohet për shkak të mbarimit të mandatit, kolonel Orbajem Kilindžom, i cili e ka mbajtur këtë pozicion që nga shtatori 2017.

Ministri Boshkoviq shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin dypalësh intensiv të arritur gjatë këtij viti, duke shprehur shpresën se bashkëpunimi i suksesshëm do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Boskovic tha se takimet në nivelin më të lartë kanë kontribuar në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Malit të Zi dhe Turqisë në fushën e mbrojtjes, veçanërisht duke theksuar rëndësinë e nënshkrimit të Marrëveshjes Ndërqeveritare për blerjen e uniformave për Ministrinë e Mbrojtjes së Malit të Zi për një periudhë prej pesë vjetësh. “Marrëveshja për furniziminme uniforma detare është zbatuar me sukses gjatë vitit aktual, por ka një plan të përcaktuar për blerje të uniformave të reja për pilotët edhe në vitin e ardhshëm”, tha ministri, duke shtuar se kjo është vetëm një segment i modernizimit të Ushtrisë së Malit të Zi.

Boskovic njohu atasheun ushtarak të turqisë me ecurinë e zbatimit të objektivave dhe aftësive, si dhe prioritetet në sektorin e mbrojtjes, duke theksuar se Mali i Zi do të mbetet i angazhuar për forcimin e kapaciteteve në sektorin e mbrojtjes duke qënë një kontribues aktiv në sistemin e sigurisë kolektive.

Kolonel Somer falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe tha se Republika e Turqisë do të vazhdojë të jetë një aleat i besueshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Malit të Zi, do të japë kontributin e saj të plotë për rritjen e bashkëpunimit të mbrojtjes. Kolonel Kilindž falënderoi për bashkëpunimin e shkëlqyer dhe theksoi kënaqësinë me përparimin që Mali i Zi i ka bërë gjatë qëndrimit të tij. Ai shprehu besimin se bashkëpunimi në mënyrë të barabartë do të vazhdojë edhe gjatë mandatit të pasardhësit të tij në detyrë.

Kolonelët Somera dhe Kilindža u pritën nga Drejtori i Përgjithshëm për Politikën e Mbrojtjes, Ivica Ivanoviq dhe shefi i Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi, nënkolonel Alexander Pantoviqi. Me këtë rast, u theksua angazhimi i Malit të Zi për forcimin e bashkëpunimit dypalësh me Republikën e Turqisë në fushat me interes të ndërsjellë.



Shtatë ushtarakë malazezë me mision në Letoni

Në grupin që drejtohet nga Kanadaja marrin pjesë 1,400 ushtarë: nga Shqipëria, Çekia, Italia, Polonia, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja.

Tetë ushtarakë të Ushtrisë së Malit të Zi u dërguan më 14 dhjetor, në Misionin ushtarak (eFP) në Letoni, si pjesë e misionit ndërkombëtar i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence-eFP) të NATO-s, si pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze të dislokuara në Letoni, ku marrin pjesë shumë vende.Ata udhëtuan me kolegë nga Forcat e Armatosura Sllovene. Grupi shumëkombësh në Letoni, i vendosur në Adagio, drejtohet nga Kanadaja. Brenda grupit, i cili ka rreth 1,400 ushtarë, janë pjesëtarë të forcave të armatosura nga Shqipërisë, Republikës Çeke, Italia, Polonia, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja.

Në Samitin në Varshavë në 2016, Aleatët ranë dakord për të rritur praninë ushtarake në pjesën lindore të Aleancës, si pjesë e politikës së mbrojtjes të NATO-s dhe të parandalimit, me katër grupe shumëkombëshe luftarake me madhësi batalioni në Estoni, Letonia, Lituania dhe Polonia në bazë rotacioni.Grupet luftarake drejtohen nga Britania e Madhe, Kanadaja, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara, që përbëjnë një forcë shumëkombëshe për të demonstruar fuqinë e lidhjeve transatlantike dhe për të bërë të qartë se një sulm mbi një aleat, konsiderohet si një sulm kundër të gjithë aleancës.Mali i Zi me praninë e saj ushtarake në Letoni tregon tendencën e vazhdueshme për të kontribuar në përpjekjet e përgjithshme të Aleancës për të forcuar sigurinë e qytetarëve të saj dhe territorin, në përputhje me Vendimin e Këshillit për Mbrojtjen e Këshillit të Sigurimit në korrik 2018.Angazhimi i anëtarëve të ushtrisë malazeze zhvillohet sipas parimit të rotacionit, për një periudhë prej gjashtë muajsh.



Gjeneral Dragutin Dakiç me kontingjentin IX në Afganistan

Gjeneral brigade Dragutin Dakiç dhe Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes, Sllobodan Filipoviqiç kanë vizituanmë 15 dhjetor kontingjentin IX të Ushtrisë së Malit të Zi i cili është në Misionin e Mbështetjes Resolute në Afganistan.

Gjatë takimit me anëtarët e kontingjentit në Marmal, shefi i Shtabit të vlerësoi punën dhe përkushtimin e tyre, duke i përgëzuar ata për realizimin e suksesshëm të detyrave të ngarkuara. Filipovic ka thënë se kuotat e mëparshme kanë vendosur standarde të larta dhe se ata duhet të ruhet, dhe se pjesëmarrja në këto misione është një përvojë shumë e rëndësishme për zhvillimin e aftësive ushtarake.

Major Rade Stijepoviç, Komandanti Kontigjenti të IX, foli në emër të të gjithë ushtarëve dhe falënderoi për vizitën dhe tha se do të vazhdojnë të zbatojnë detyrat e caktuara dhe do të përpiqen vazhdimisht për të ruajtur standardet e arritura, por edhe duke i ngriturata në një nivel më të lartë.Gjatë vizitës në Afganistan, General Dakiq dhe Filipovic u takua me Komandantin e Veriut (North TAAC), gjeneral brigade Klafusom dhe zëvendësin e tij, koloneli Bogart, ku folën për situatën aktuale në Afganistan. Komandanti i Veriut (North TAAC), gjeneral brigade Klafusom tha se ishte i nderuar që ju krijua mundësia për t’u takuar me krerët e ushtrisë të Shtabit të Përgjithshëm të Malit të Zi dhe Sekretari e Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes të Malit të Zi dhe falënderoi me rastin e pjesëmarrjes së Malit të Zi në misionet ndërkombëtare.

Anëtarët e kontingjentit u njohen me detyrat dhe aktivitetet që aktualisht po zbatohen në Armatën e Malit të Zi.Shefi i Shtabit dhe Filipoviq morën pjesë në operacionet e përbashkëta Center TAAC Veriut, dhe u takuan me komandantin e kontigjentit kroat, si dhe komandantin e trupave ndërkombëtare.

Deklaron nënkolonel Alexander Pantoviqi

Integrimi në NATO ka sjellë progres për ushtrinë malazeze

“Hartimi i dokumenteve strategjike në fushën e mbrojtjes, miratimi dhe ratifikimi i tyre, vazhdimi i modernizimit të Ushtrisë së Malit të Zi, dhe ajo që është shumë e rëndësishme, blerja tre helikopteri Bell, por vendosja e misionit të Policimit Air, janë disa nga aktivitetet më të rëndësishme të realizuara gjatë këtij viti si pjesë e Planit të Integrimit ushtarak të Malit të Zi në NATO. Qeveria malazeze këtë muaj miratoi dokumentin “Për zbatimin e Planit të integrimit ushtarake të Malit të Zi në NATO”, tha shefi i Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi, nënkolonel Alexander Pantoviqi.Ai theksoi se gjatë vitit 2018 ka vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikuara nga procesi i integrimit të Malit të Zi në NATO.

Nënkolonel Pantoviqi në mënyrë specifike ka përmendur hartimin e dokumenteve strategjike, të cilat janë bazë për vazhdimin e reformave në sektorin e mbrojtjes. Këto janë “Strategjia e Mbrojtjes për Sigurinë Kombëtare” dhe “Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes në aspektin afat-gjatë”, të cilat janë në ndërtim e sipër.Mali i Zi gjatë këtij viti ka miratuar dhe ratifikuar 127paketa ligjore sipas standardet e NATO-s.Nënkolonel Pantoviqi tha se procesi i pajisjes dhe modernizimin e Forcave të Armatosura të Malit të Zi këtë vit shënoi progress me blerjen e tre helikopterëve Bell-412, si dhe marrja e gjashtë automjeteve për policinë ushtarake si donacione nga gjermania. Ai shtoi se ka përfunduar faza e dytë e rindërtimit të raketa-hedhësit RTOP-405.

Ndërkohë procesi i reformës do të vazhdojë në përputhje me Vendimin mbi strukturën e re organizative dhe madhësinë e Ushtrisë së Malit të Zi.Në vitin 2018 forcat e ushtrisë malazeze ubënë pjesë e misionit të KFOR-it të NATO-s në Kosovë, dhe këto ditë filloi misioni në Letoni, ku u dërguan tetë ushtarakë si pjesë e misioneve ndërkombëtare në Letoni.Ai gjithashtu tha se Ministria e Mbrojtjes ka formuar Departamentin për mbrojtjen kibernetike dhe për t’iu përgjigjur kërcënimeve të (CD/CIRT) ushtarakë nga Mali i Zi kanë marrë pjesë në 22 ushtrime stërvitore ndërkombëtare,ku janë angazhuar 302 ushtarakë.

> F-16 është një gjuajtës reaktiv me shumë role i zhvilluar fillimisht nga General Dynamics për Forcën Ajrore të Shteteve të Bashkuara (USAF). I dizejnuar fillimisht si gjuajtës dite i superioritetit ajror, ai ka evoluar në një avion të suksesshëm për të gjitha motet dhe me shumë role. Mbi 4.500 aeroplanëve janë ndërtuar që nga fillimi i prodhimit në vitin 1976.



Sfida e tre shteve: SHBA, Suedi dhe Itali

Bullgari: 900 milion euro për 8 gjuajtës ajror

Ofertat për gjuajtës ajror janë paraqitur nga ShBA me F-16, Suedia me "Gripen" dhe Italia me "Jurofajtër"

Vazhdon gara e ethëshme e dërgimit të informacioneve suplementare për ofertatlidhur me gjuajtësit ajror për Forcat UshtarakoAjrore Bullgare. Projekti për gjuajtësit e rinj është për 900 milion euro. Bullgaria pret të marrë deri në 8 gjuajtës.

Para pak ditësh, nga Brukseli kryeministri Bojko Borisov shprehu shpresën se Bullgaria do të marrë oferta më të leverdishme për gjuajtës të rinj F-16. "Aeroplani i ri F-16 është më i mirë nga të gjithë të tjerët. Do të jetë mirë të disponojmë makina të mira luftarake, në të cilat kur ngjiten pilotët të dinë se kanë shans të fitojnë", tha kryeministri. Janë tre shtete me tre oferta që po luftojnë me njëra tjetrën. Oferta për gjuajtës të rinj F-16 janë nga ShBA-ja. Suedia ofron aeroplan të rinj "Gripen", ndërsa Italia-gjuajtësit "Jurofajtër" përdorim të dytë. Ndërkohë kryeministri i Suedisë shpalli ofertën e saj të re dhe më të favorshme për Bullgarinë për furnizimin e avionëve asgjësues "Gripen".

Por edhe amerika ka reaguar, me një tjetër ofertë me informacione te tjera suplementare. Në sajtin e Departamentit të Shtetit të ShBA-së u botua njoftimi, se Uashingtoni mirëpret planin për modernizimin e mbrojtjes së Bullgarisë dhe pret me padurim zgjedhjen e ardhshme për një gjuajtës të ri me shumë qëllime. Theksohet, se në një bisedë telefonime me kryeministrin Bojko Borisov më 18 dhjetor sekretari i shtetit i ShBA-së Majk Pompeo siguroi, se ShBA-ja angazhohen të punojnë me qeverinë bullgare për arritjen e kontratës për gjuajtësit F-16, e cila të jetë në përputhje me buxhetin e vendit dhe të kërkesave të sistemit të operacionit, dhe në këtë kontekst janë gati të bëjnë një ofertë më të mirë. Brenda 25 viteve të fundit ShBA-ja i ka siguruan Bullgarisë ndihmë për 200 milion dollarë për rritjen e stafit ushtarak dhe për përputhjen e sistemit operativ me NATO-në.

F-16 është një gjuajtës reaktiv me shumë role i zhvilluar fillimisht nga General Dynamics për Forcën Ajrore të Shteteve të Bashkuara (USAF). I dizejnuar fillimisht si gjuajtës dite i superioritetit ajror, ai ka evoluar në një avion të suksesshëm për të gjitha motet dhe me shumë role. Mbi 4.500 aeroplanëve janë ndërtuar që nga fillimi i prodhimit në vitin 1976. Pas Luftës së Dytë Botërore, pas Mig 29 (10.000+) është aeroplani luftarak i dytë më së shumti ekzemplar të prodhuar. Edhe pse nuk blihet më nga Forcat Ajrore Amerikane, versionet e përmirësuara janë ende duke u ndërtuar për klientët e eksportit. Në vitin 1993, General Dynamics i shiti biznesin e prodhimit të vet të avionëve korporatës Lockheed, i cili në vazhdim u bë pjesë e Lockheed Martin, pas një shkrirje në vitin 1995 me Martin Marieta.

Fighting Falcon (skifteri luftarak) është një gjuajtës me risi të shumta, duke përfshirë një kabinë në formë flluske për shikueshmëri më të mirë, shkop kontrolli të montuar anash për të



lehtësuar kontrollin, një ulëse të pjerrët prej 30 gradë për të zvogëluar efektin e forcave-G në pilotin, dhe përdorimin e parë të stabilitetit të relaksuar statik/sistemin e fluturimit me tel për kontrollin e fluturimit që e bën atë një avion të shkathët. F-16 ka brenda topin M61 Vulcan dhe 11 vende për të varur armë dhe pajisje të tjera të misionit. Emri zyrtar i F-16 është "Fighting Falcon", por zakonisht nga pilotët e saj quhet "Viper", për shkak të një ngjashmëri të perceptuar me gjarprin, si dhe Galactica Battlestar Colonial Viper Starfighter. Përveç forcave aktive të Forcave Ajrore të SHBA-së, Komandës së Forcës Ajrore Rezervë, dhe njësive të Forcës Ajrore të Gardës Kombëtare, avioni është përdorur edhe nga ekipi amerikan i demonstrimeve ajrore U.S. Air Force Thunderbirds, si dhe si avion kundërshtar/agresor nga ana e Forcës Detare të Shteteve të Bashkuara. F-16 gjithashtu shërben në forcat ajrore të 25 shteteve të tjera. Supozohet që F-16 të jetë në shërbimin e Forcave Ajrore të SHBA-së deri në vitin 2025.

Në nderim të historisë ushtarake bullgare

Në Ministrisë së Mbrojtjes të Bullgarisë u zhvillua takimi vjetor me përfaqësuesit e shoqatave ushtarake-patriotike të ushtarakëve në reserve. Ata u përshëndetën më 11 dhjetor nga Ministri i Mbrojtjes Karakacanov dhe shefi i Përgjithshëm Mbrojtjes Andrew Botsev, duke vlerësuar rolin dhe kontributin e tyre në edukimin ushtarako-patriotik e forcimin e sigurisë në mbrojtjes së vendit. Ky ishte takimi tradicional i përfaqësuesve të udhëheqjes së Ministrisë së Mbrojtjes me anëtarët e shoqatave ushtarake dhe patriotike, e cila u mbajt në Klubin Qendror Ushtarak në Sofje. Me këtë rast u dhanë dekorata nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Mbrojtjes Anton Lastardzhiev dhe zëvendës-shefi i Ushtrisë Admiral Emil Evtimov. Sekretari i Përhershëm i Mbrojtjes Anton Lastardzhiev përgëzoi anëtarët e organizatës në emër Ministrit Karakacanovi dhe shprehu besimin se bashkëpunimi i mirë i Ministrisë së Mbrojtjes me organizatat ushtarake-patriotike do të vazhdojë. "Pjesëmarrja në ngjarje të përbashkëta është në respekt dhe nderim të historisë sonë ushtarake dhe heronjve të saj", tha zëvendës shefi i Mbrojtjes, Admiral Emil Eftimov në fjalimin e tij për pjesëmarrësit në takim. Ai ka falënderuar përfaqësuesit e organizatave ushtarake-patriotike në vend për shërbimin e gjatë në Forcat e Armatosura dhe veprimtaritë aktive për ruajtjen dhe zhvillimin e traditave ushtarake bullgare.



FONDACIONI "FËMIJËT E USHTRISË BULLGARE"

Bursa dhe pagë mujore për fëmijët e ushtarakëve



"Angazhimi ynë për të mbështetur fëmijët e ushtarakëve bullgare është i pakthyeshëm. Kjo është një shprehje e mirënjohjes tonë për familjet që kanë pësuar një humbje të rëndë". Me këto fjalë ministri i Mbrojtjes Karakacanov iu drejtua fëmijëve të personelit ushtarak dhe civil të cilët kanë hunbur jetën në krye të detyrës. Takimi u mbajt, 12 dhjetor, në Klubin Qendror Ushtarak në Sofje. Ajo u ndoq nga shefi i Mbrojtjes gjeneralit Andrei Botsev, zëvendës komandanti Forcave të Përbashkëta të Komandës, komandanti i Forcave Tokësore dhe Forcave Ajrore, Gjeneral Major Mikhail Popov dhe gjeneral major Tcanko Stojkov dhe drejtori i "Politikës sociale" Ivo Antonov.

Në prag të festave të Krishtlindjeve fëmijët e ushtarakëve ndanë arritjet e tyre gjatë vitit që po mbyllet. Artistja e talentuar Veselina Gekova, e cila ka përfunduar Universitetin e Arteve ka hapur një ekspozitë ku prezantoi punën e saj në bronz-skulpturë të vogël, simbol i Sofjes. Kjo statujë është bërë për pjesëmarrësit në Konferencën Evropiane të Këshillit Ndërkombëtar për Sporteve Ushtarake (CISM), ku Sofia ishte nikoqir në vitin 2018.

Ministri Karakacanov siguroi bijtë e ushtarakëve bullgare, se ata do të kenë mbështetjen dhe ndihmën maksimale të Ministrisë së Mbrojtjes.

"Udhëheqja ushtarake e Ministrisë së Mbrojtjes, beson në aftësitë tuaja", ka deklaruar shefi i Mbrojtjes gjenerali Andrei Botsev. Ai theksoi se një vendim i Bordit të Fondacionit "Fëmijët e ushtrisë bullgare" nga 1 janar 2019 do të rrisë sasinë e bursave mujore që fëmijët marrin. "Ne duam përzemërsisht që të jemi pjesë e zhvillimit tuaj të ardhshëm, pjesë e suksesit dhe arritjeve tuaja", tha gjenerali Botsev.

Këtë vit Fondacioni "Fëmijët e ushtrisë bullgare" kujdeset për 35 fëmijë të ushtarëve dhe civilëve që kanë humbur jetën në kryerjen e detyrës, dhe u jep atyre me një pagë mujore. Fondet janë ngritur nga donacionet e personelit ushtarak dhe civil të Forcave të Armatosura.

Gazeta franceze, “Journal des Débats Politiques et Littéraires”

“Nuk ka më kohë për të humbur”

Intervista ekskluzive e Ismail Qemalit në Vjenë (1912): “Ja ç’kërkojmë ne shqiptarët”

NGA AURENC BEBJA

Gazeta franceze, “Journal des Débats Politiques et Littéraires”, ka botuar të martën e 26 nëntorit 1912, në ballinë, intervistën e Ismail Qemalit, zhvilluar në Vjenë me gazetarin me inicialet M. P.Udhëheqësi shqiptar ka folur asokohe për gabimet e rënda qeverisëse të xhonturqve, për qëllimet e tmerrshme të Serbisë në vendin tonë dhe mbi të gjitha për pavarësinë e Shqipërisë.Në vijim, do të gjeni intervistën e plotë, të sjellë në shqip nga Aurenc Bebja-Blogu “Dars (Klos), Mat – Albania”:

Letër nga Vjena
Ismail Qemali dhe
çështja shqiptare,
Vjenë, 21 nëntor 1912.



Ismail Qemal Beu, një nga udhëheqësit më të padiskutueshëm të Kombit Shqiptar, u ndal për disa ditë në Vjenë. Ai erdhi nga Budapesti, ku politikanët hungarezë i rezervuan një mikpritje të ngrohtë dhe ku personazhet zyrtare të monarkisë, pa u distancuar nga rezerva diplomatike e imponuar prej rrethanave, nuk i fshehën atij simpatinë dhe interesin e tyre për çështjen që ai mbron. Ai, me gjithë këmbënguljeve të tij, nuk arriti të takonte dukën Bertchold; gjithsesi atë e vunë në kontakt me disa zyrtarë të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Momenti i vizitës së tij në Budapest rastisi, për më tepër, në kulmin e krizës austro-serbe: çështja e konsujve shqetësonte opinionin publik, tashmë i pakënaqur me qëndrimin e papajtueshëm të Serbisë për çështjen e porteve. Ismail Qemali gjeti në Austro-Hungari një atmosferë të favorshme për projektet e tij: ai dukej disi i shqetësuar dhe nervoz.

“Po largohem sonte, më tha ai, për Trieste. Një anije austriake do të më çojë në Durrës, ku shpresoj të arrij para se të mbërrijë ushtria serbe. Nuk ka më kohë për të humbur. Miqtë e mi dhe unë do të përpiqemi të organizojmë një komitet mbrojtës në vend, një lloj qeverie të përkohshme. Por, duhet më në fund që Evropa të dalë nga indiferenca e saj dhe të manifestojë me anë të akteve interesin që dëshmon se ka për çështjen tonë të pafat. Në Austri, në Gjermani, si edhe në Francë dhe Angli, opinioni publik është në favorin tonë; e drejta jonë njihet unanimisht dhe ruajtja e pavarësisë sonë duket se është në përputhje jo vetëm me parimet e diplomacisë evropiane, por edhe me interesat e fuqive të mëdha. Çfarë po pret Evropa për të na mbështetur? Do të jetë e padobishme shpallja e të drejtës së kombit tonë për ekzistencë dhe autonomi kur ne nuk do të ekzistojmë më. Qëllimi i serbëve është i qartë: ata djegin, masakrojnë gjithçka gjatë rrugës së tyre; nuk u mjafton pushtimi i Shqipërisë, ata duan të shfarosin shqiptarët.”

Ismaili i moshuar uli kokën dhe heshti për disa çaste, pastaj rifilloi:

“Ne nuk mundemi, nuk duam të bëhemi sllavë. Nga të gjitha kombet që popullojnë Ballkanin, i yni është më i vjetri. Është e vërtetë se ne nuk jemi shumë të civilizuar: kemi vuajtur kaq shumë! Por, a është kjo një arsye që një pemë, për shkak të mungesës së kujdesit, të pritet se nuk ka lulëzuar? Ne ishim të parët, pas vitit 1908, që u ngritëm kundër pretendimeve tiranike të qeverisë xhonturke. Duke kërkuar atëherë reforma dhe një trajtim më të drejtë, duke protestuar kundër kërkesave të papajtueshme me zakonet dhe kushtet tona, ne nuk mbronim ekskluzivisht vetëm të drejtat e racës sonë, por edhe ato të të gjitha kombësive: programet tona asokohe dëshmojnë për këto qëllime. Përpjekjet tona nuk patën sukses: ata u shtypën nga represionet më të padrejta dhe të dhunshme. Popujt e Ballkanit u bashkuan; ata morën përsipër çështjen që ne tentuam të mbronim. Dhe sot që ata triumfojnë, veprimi i tyre i parë është që të kthehen kundër nesh! Ata i njohin qëllimet tona, të cilat nuk janë armiqësore ndaj tyre: ne i konsideronim si aleatë. Ata e dinë se ne nuk do të ndjekim asnjë plan zgjerimi dhe propagande; ne kërkojmë vetëm një gjë: që të na lënë të jetojmë në territorin ku gjendemi. Dhe këtë pretendim, ne do ta mbështesim deri në fundin më ekstrem. Ne nuk do të lejojmë as aneksimin, as ndarjen dhe as zhytjen e popullit tonë në rrjedhën e një popullsie të huaj.

Çështjet e gjetjes së formulës politike apo ajo për krijimin e një qeverie janë dytësore, dhe, në kohën e tashme, na shqetësojnë pak. Pika thelbësore është që tani e tutje ndjenja kombëtare mbizotëron mbi të gjitha ndjenjat e veçanta, preferencat politike ose rivalitetet konfesionale.

Katolikët, ortodoksët, myslimanët, të gjithë shqiptarët janë të bashkuar për të mbrojtur të drejtat e kombit dhe pavarësinë e Shqipërisë.”

Ismail Qemali pati përdorur gjatë bisedës fjalët “pavarësi” dhe “autonomi”. E pyeta nëse shqiptarët tashmë ishin të qartë për synimet e tyre. Ai bëri një gjest apatik:

“Çfarë vlere ka të luash me fjalët? – tha ai. Askush nuk e kishte dëshiruar më shumë se unë rigjenerimin e Perandorisë Osmane; askush nuk ishte më i vendosur se unë për të sakrifikuar shumë, gjithçka që ishte e mundur për të sakrifikuar, që Turqia të bëhej një shtet modern, i qeverisur dhe i administruar mirë, i qëndrueshëm dhe i fortë. Ne jemi rebeluar vetëm kundër abuzimit të pushtetit nga një parti, e cila paragjykonte të drejtat tona dhe kishte për qëllim të na shtypte si komb. Kjo parti, tashmë, ka shkatërruar Turqinë: çfarë do të mbetet në Evropë nga Perandoria Osmane? Nuk bëhet më fjalë për një Shqipëri autonome që i nënshtrohet sundimit të Turqisë. Lidhjet me një provincë të izoluar dhe të largët nga Perandoria do të ishin artificiale dhe të vështira për t’u mbajtur. Ne nuk kërkojmë autonominë, por pavarësinë: një pavarësi që nuk kërcënon askënd dhe madje u ofron disave garanci.”

Ismail Qemali e dinte se para se të shkoja për ta takuar, kisha takuar Hysen Xhahidin, ish-drejtorin e Taninës, i cili, duke u larguar nga Kostandinopoja, si arsye e kërcënimit të një dënimi, kishte gjetur strehim në Vjenë. Ai më pyeti se çfarë mendonte Xhahidi për ngjarjet dhe si e parashikonte të ardhmen. Unë nuk i fsheha se u befasova nga optimizmi i tij. Ai nuk kishte humbur asgjë nga entuziazmi dhe besimi i tij i mëparshëm. Përvoja që kishte dështuar në Evropë do të ripërtërihej në Azi, ku ajo kishte një shans më të mirë për të pasur sukses. Atje, asnjë besdisje, asnjë pengesë. Armenët nuk mund të përbënin një rrezik: ata kishin aq shumë interesa të përbashkëta me turqit! Arabëve do t’u jepej një autonomi e gjerë. Progresi do të arrihej pak nga pak. Vendi do të organizohej, do të bëhej i begatë.

“Ëndrra ! -tha Ismaili. Asnjë realitet, kaq brutal dhe i tmerrshëm sa është, nuk do të zgjojë këta njerëz ! Ata kanë shkatërruar, nga gabimet dhe arroganca e tyre, situatën më të bukur e më të pashpresë në botë. Çfarë simpatie dhe besimi gëzonte Turqia në Evropë pas revolucionit! Fakti ishte i papritur, dukej se u shfaq një fuqi jetike dhe energjitike me burime të pazbuluara. Evropa në tërësi i besoi Turqisë së re dhe i ofroi ndihmën e saj. Ata nuk kuptuan dhe shfrytëzuan asgjë. Sa herë kam provuar t’u hap sytë, u lutesha atyre që të mos shpërdornin avantazhet e një situate unike, të cilën vendi nuk do ta gjejë më kurrë; Nuk do të përfitonin vetëm ata, por e gjithë Perandoria. Për disa muaj, ata u tjetërsuan nga të gjithë: fuqitë e mëdha, që u trajtuan me një mëndjelehtësi të pabesueshme, na kthyen shpinën; në brendësi të Perandorisë, kombësitë e kërcënuara prej një politike të verbër dhe brutale, menduan të shkundnin zgjedhën që u bënte ekzistencën e tyre të pamundur. Rezultati i gjithë kësaj është historia e këtyre ditëve të fundit: pa dyshim, që ende nuk u duket mjaft e qartë.” Ismail Qemali, ndërsa isha gati t’i them lamtumirë, këmbënguli përsëri me shpresën se do të shihte Fuqitë e Mëdha të Evropës, të mbështesnin, në mënyrë efektive, kërkesat e Shqipërisë. Ai dukej shumë i kënaqur me aranzhimet që pati në Austro-Hungari, shumë më pak me ato që shtypi italian shkruante prej disa ditësh. “Shtypi, i thashë, nuk e përkthen gjithmonë mendimin e qeverisë.” Ismaili tundi kokën dhe nuk u përgjigj. M.P.

10 fakte historike nga jeta e Ismail bej Vlorës

Historiani turk Nexhip Alpan ka shkruar një libër historik për themeluesin e shtetit shqiptar Ismail Qemalin

1.Datëlindja: Sipas historianit turk Alpan, ditëlindja e saktë e Ismail Qemalit është 16 tetor 1846.Deri në vitet ’90, teksti zyrtar i historisë së Shqipërisë, Fjalori Enciklopedik, por edhe në memuarë të tjerë, Ismail Qemali nuk ka pasur një datë të lindjes, por shënohej vetëm viti, 1846.

2.Emri real: Një tjetër kuriozitet nga jeta e themeluesit të shtetit është se në të gjitha dokumentet e kohës ai quhet Ismail Bej Vlora dhe jo Ismail Qemali, apo Ismail Bej Qemali.Sidoqoftë, Ismail Qemali duket se ka fituar të drejtën e qytetarisë, pasi kështu gjendet pothuajse në të gjithë librat zyrtarë të historisë.

3.Martesat dhe fëmijët: Ismail Qemali u martua dy herë. Për herë të parë me një vejushë nga Konica, që vdiq gjatë lindjes së bashku me vajzën, herën e dytë u martua në vitin 1886, me Kleoniqi Surmeli, vajza e një fisniku grek nga krahina e Edrenesë.Ismail Qemali u detyrua ta rrëmbente gruan e dytë, pasi ligjet e ndalonim martesën e një myslimani me një ortodokse. Nga martesa e dytë Ismail Qemali pati 9 fëmijë, tri vajza dhe gjashtë djem. Vajzat quheshin Myvedet, Alije, Ylvie. Ndërsa djemtë ishin Mahmud Bej, Tahir Bej, Et’hem Bej, Xhevdet Bej, Qazim Bej dhe Qami Bej.

4.Poliglot: Ismail Qemali dinte, veç shqipes, edhe shtatë gjuhë, të cilat ishin osmanishtja, turqishtja e re, greqishtja e vjetër, latinishtja, italishtja, frëngjishtja, sllavishtja.

5.Vdekja, e dyshimtë: Ismail Qemali vdiq në rrethana misterioze në Peruxha të Italisë, pak momente para se të jepte një konferencë për shtyp. Deri më sot nuk ka në fakt një variant përfundimtar të vdekjes së tij, por gjithmonë janë hedhur dyshime. Mendohet se ai është helmuar. Kufoma e Ismail Qemalit është mbajtur në Peruxha për dy javë pas vdekjes, me idenë e balsamosjes. Por kjo i shtoi edhe më shumë dyshimet për helmim, pasi iu hoqën organet e brendshme duke zhdukur çdo shenjë për autopsinë.

6.Flamuri që ngriti: Ka pasur diskutime dhe ende nuk është zgjidhur se cili flamur është ngritur më 28 Nëntor 1912 në ballkonin e shtëpisë historike të Vlorës. Një variant është se flamurin e qëndisi Marigo Pozio, një nuse e shtëpisë ku fjeti Ismaili natën e fundit; një variant tjetër është se flamurin e solli Spiridon Ilo nga SHBA; ndërsa varianti i tretë është ai Eqrem bej Vlorës, sipas të cilit, flamurin ia kishte falur Aleadro Kasstriota, burri i një princeshe që pretendonte se ishte pasardhëse e Skënderbeut.

7.Fotoja simbol: Fotoja simbol e Shpalljes së Pavarësisë ka ngelur ajo e datës 1 dhjetor 1912. Deri më sot nuk ekziston asnjë fotografi nga momenti i Shpalljes së Pavarësisë më 28 Nëntor të vitit 1912.

8.Dokumenti i Pavarësisë: Nuk është gjetur dokumenti original i Shpalljes së Pavarësisë. Ai që është, është kopje e Lef Nosit, i cili në qeverinë e parë shqiptare ishte ministër i Postë-Telegrafës.

9.Sa qëndroi në pushtet: Ismail Qemali, si kryeministër dhe kryetari i parë në historinë e shtetit shqiptar qëndroi në krye të qeverisë nga data 28 Nëntor e vitit 1912 deri në 22 janar 1914, dmth, 12 muaj e 56 ditë.

10.Eshtrat: Si fillim, kufoma e balsamosur e Ismail Qemalit u varros sipas porosisë së tij, në Kaninë. Ceremonia e varrimit u bë me 12 shkurt 1919, ditën e mërkurë. Pas 13 vitesh të prehjes në kalanë e Kaninës, trupi i pajetë i kryeministrit të parë të shtetit shqiptar u zbrit në Vlorë, në datën e shënuar të 28 nëntorit 1932, me rastin e 20 vjetorit të shpalljes së pavarësisë.Trupi i Ismail Qemalit u vendos në atë vend ku ndodhet edhe sot, në “Sheshin e Flamurit” në Vlorë. Varri monumental i Ismail Qemalit ka figurën e “Flamurtarit”, një vepër kjo e skulptorit të shquar Odise Paskali.

NË 75 VJETORIN E RËNIES

Ali Demi i Çamërisë, rënë në Labëri



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Kontributi i luftëtarëve çamë në formacionet e ELLAS-it dhe të EAM-it

Në përgatitjen e luftës kundër Greqinë, Italia po përdorte në interes të saj gjendjen diskriminuese të shqiptarëve në Çamëri. Kur shpërtheu lufta italo-greke në vitin 1940, u thelluan tensionin politike në Çamëri. Qenë të shumta përpjekjet nga pushtuesi për të patur bashkëpunëtor nga minoriteti shqiptar. Popullsia çame gjatë regjimit fashist të Metaksait kishte vuajtur shumë, pornë këtë luftë mbajti qendrim neutral ndaj palëve. Me thyerjen e ushtrisë italiane dhe tërheqjes e saj nga Greqia, dhuna dhe terrori mbi popullsinë shqiptare të Çamërisë, u bë më intensive, prej qeverisë së re greke. Për të përballuar gjendjen e rëndë të krijuar nga pushtuesit e rinj gjermanë, çamët zgjodhën rrugën e bashkëpunimit dhe të bashkëjetesës. Kështu u organizuan dy mbledhje në Koskë dhe në Spatar, ku njerëz me ndikim në krahinë si Musa Demi, Shuaip Llajo, Isuf Izeti, Xhaferr Çafuli, Jasin Sadiku dhe shumë të tjerë, punuan për të krijuar mirëkuptim midis komunitetit grek dhe shqiptar. Popullsia çame nuk pranoi të bashkëpunonte me gjermanët dhe nuk i përdori armët kundër popullsisë greke. Ajo u rezistoi me vendosmëri përpjekjeve për ta hedhur kundër elementit grek. Forcat shoviniste greke u shqetësuan shumë, kur u bë ngritja e këshillave shqiptarë në të gjithë Çamërinë. Në dimrin e viteve 1942-1943, popullsia çame u organizua në luftën kundër fashizmit, dhe në verën e vitit 1942, krijoi në Filat grupin ilegal të rezistencës antifashiste të përbërë nga Njazi dhe Kasem Demi, Mustafa Sulo, Dervish Dojaka, Muharrem Demi, Braho Karasani, Sami Alushi, Tahir Demi, Vehip Huso e shumë të tjerë. Këta punuan për organizimin e rezistencës, për krijimin e bazave të luftës, për popullarizimin e ideve të Kartës së Atlantikut, e cila u garantonte popujve e pakicave etnike liri, barazi dhe të drejtën e vetëvendosjes pas fitores mbi fashizmin.

Në mars të vitit 1943, u formua çeta e parë mikste, e cila bashkëpunonte me Ushtrinë Nacionalçlirimtare Greke (EAM). Edhe kundërshtarët nuk e mohojnë kontributin dhe pjesëmarrjen e çamëve myslimanë në radhët e rezistencës antifashiste greke, në formacionet



e ELLAS-it dhe të EAM-it. Çamët nxorrën mbi 1.000 luftëtarë, pa marrë parsysh edhe qindra të tjerë që punonin në terren. Nga radhët e ELLAS-it ranë në luftë 68 partizanë çamë. Në shkurt të vitit 1943, u krijua çeta "Çamëria" dhe më pas batalioni "Çamëria", i cili në shtator të vitit 1943 zhvilloi betejën e famshme të Konsipolit kundër gjermanëve, që zgjati 55 ditë. Ajo betejë u shqua për pjesëmarrjen e gjerë të popullsisë së Çamërisë, të Delvinës dhe të minoritetit pa dallim kombësie apo shtresash shoqërore. Në pranverë të vitit 1944, në Qeramicë, u formua batalioni i katërt "Ali Demi" me më shumë se 500 luftëtarë çamë. Batalioni hyri në përbërje të Regjimentit XV të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Greke (EAM). Në luftimet e zhvilluara ranë trimërisht dëshmorët Muharrem Myrtezai, Ibrahim Halluni, Husa Vejseli etj. Luftëtarë të tjerë çamë morën pjesë në Brigadën VI, VII, IX dhe XI të ushtrisë greke. Misioni britanik në Çamëri, nuk e ka mohuar pjesëmarrjen e tyre në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Greke (EAM).

Labëria dhe Çamëria në krah të njëra-tjetrës

Labëria dhe Çamëria janë dy krahinat më jugore të Shqipërisë. Historikisht kanë ndarë së bashku hidhërimet dhe gëzimet. Armiqtë e Labëria kanë qenë dhe armiq të Çamërisë. Ndaj ato i janë gjendur, historikisht në rrjedhën e kohërave, gjithnjë pranë njera tjetrës. Kështu ndodhi edhe në Luftën e Dytë Botërore kundër pushtuesve nazifashistë. Formacione luftarake të Çamërisë luftuan e derdhën gjak krahas atyre të Labëri, ashtu sikurse bënë edhe formacionet luftarake të Labërisë në trevën e Çamërisë. Bijt dhe bijat e të dy krahinave dhanë ndihmesë të ndërsjelltë edhe për organizimin e luftës çlirimtare. Bilbili i Labërisë Mustafa Matohiti, komandanti legjendar Bexhet Mema apo "Labi i Kuçit", Jaho Gjoliku etj., dhanë ndihmesë të drejtpërdrejtë në ngritjen e popullit çam në luftë dhe drejtimin e batalionit apo të grupit partizan "Çamëria".


Krahina e Konispolit ishte një nyje e rëndësishme dhe ajo vlerësohej prej pushtuesve si një pikë lidhëse midis dy anëvë të kufirit, por dhe me bregdetin. Nga ana tjetër, Stabi i Përgjithshëm e shikonte minoritetin grek në Shqipëri dhe zonën e Çamërisë, si ura lidhëse e bashkimi midis dy popujve për të luftuar pushtuesin e përbashkët. Nga marrëveshja e arritur midis Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacional Çlirimtar Shqiptar (KPNÇSH) dhe Frontit Nacionalçlirimtar Grek (EAM), përfaqësues nga të dy vendet u dërguan pranë masave popullore për të shpjeguar këtë proces. Kjo bëri që të rreshtoheshin në forcat partizane të UNÇSH e të ELAS shumë luftëtarë nga dy vendet. Ndërsa në përshkrimin e luftimeve në sektorin e Konispolit, në prill 1944 thuhet: Pasi dështuan të gjitha tentativat nazi-balliste të mëparshme për të okupuar zonat e lira të Vurgut e të Konispolit, armiku me tradhtarët që nga data 16 prill me forca të konsiderueshme prej afro 3.000 veta sulmuan rishtas nga 8 drejtime. Kudo u pritën me luftë nga batalionet e Gr4P. Në këto veprime kanë marrë pjesë nga ana e Greqisë dhe disa forca të Regjimentit 15 të UNÇ Greke.

Biri i Çamërisë, Ali Demi

Ndërkohë, biri i Çamërisë së cfilitur nga shovinizmi grek, Ali Demi, do të jepte një ndihmesë të shquar në organizimin e qëndresës popullore kundër fashizmit në krahina të ndryshme të Shqipërisë si në Çermenikë, Kërrabë, Zaranik dhe në trevën e Labërisë e kryesisht në Vlorë e Mesaplik. Aliu u lind në janar të vitit 1918 në një familje të varfër në Filat të Çamërisë. Babai, Ahmeti, vdiq shpejt. Nëna, Nazia, e rriti me mundime. Me këmbënguljen e atdhetarëve çam, Aliu, bashkë me fëmijë të tjerë u dërgua në konviktin e Sarandës, në shkollën fillore. Në moshën 15 vjeçare regjistrohet në gjimnazin e Gjirokastrës. Aty Aliu do studionte dhe literaturë tjetër, sidomos revistat "ABC" dhe "Bota e Re". Në gjimnaz u njoh me djem atdhetar si Themo Vasi e Farudin Imshta. Admironte e përkrahte lëvizjen antizogiste. Bashkë me shokët u vu në krye të konviktorëve për trajtesë më të mirë ekonomike e kryesisht kundër përpjekjeve për të futur në shkollë frymën fashiste. U përjashtua nga gjimnazi.

Pas peripecish të shumta Aliu u regjistrua në gjimnazin e Tiranës. Këtu u vu në lidhje me të rinj revolucionar, si me Qemal Stafën, me Vasil Shanton dhe u lidhur me grupin komunist të Shkodrës. Shtëpia në Tiranë me nr. 66 ku banonte Aliu u kthye në bazat e para kryesore të PKSH në qytet. Aliu ra në sy të shërbëtorëve të fashizmit dhe më 20 shkurt 1942 arrestohet. Qëndroi heroikisht në hetuesi dhe me besim në fitore, Aliu shpejt fitoi zëmrat e të burgosurve dhe, së bashku me komunistë të tjerë, i organizoi ata për qëndresë. Aliu ishte i rrezikshëm për italianët e shërbëtorët e tij. Ndaj së bashku me 9 shokë të tjerë ata vendosën t'i ekzekutojnë. Por vetëm demonstratat e të burgosurve dhe këmbëngulja e tyre deri në sakrificën supreme, detyruan administratën fashiste të tërhiqej me turp. Më 29 Prill 1943, Aliu me 26 të burgosur të tjerë, pas një pune këmbëngulëse dhe në heshtje të plotë, hapën një tunel të nëndheshëm dhe u arratisën nga burgu. Shkoi në Çermenikë, ku u caktua komisar çete në batalionin e Çermenikës dhe kreu luftime në Shqipërinë e Mesme. Më pas, u emërua sekretar i Qarkorit të Partisë Komuniste për Vlorën e më pas si sekretar politik. Në krye të detyrës, Aliu u gjend kudo në fshatrat e krahinës së Vlorës. Trimëria dhe guximi i tij spikatën në luftimet e Drashovicës, të Gjormit etj. Ai dha një ndihmesë në përgatitjet për krijimin e Brigadës V Sulmuese. Duke qenë gjithnjë në lëvizje, Aliu ra sërish në sy të pushtuesit. Në mbrëmjen e 19 dhjetorit 1943, ishte duke u kthye natën vonë në bazën e tij në Kaninë, dhe pse në kalanë e Kaninës kishte gjermanë. Baza e tij ishte rrethuar nga gjermanët e ballistët. Thirrjes së tyre për t'u dorëzuar, Aliu me dy shokët, ju përgjigj me grykën e maliherit. Mbi ta filluan të bien edhe predha artilerie e mortajash. U vra shoku i tij Pano Dhimëgjoka. Plagoset shoku tjetër. Aliu për të mos rënë i gjallë në duart e armikut, çan rrethimin, por te qafa e Dheut të Bardhë goditet për vdekje.

Më 9 Korrik 1945, Këshilli i Përgjithshëm Antifashist, i jep titullin më të lartë, plotësisht të merituesëm, "Hero i Popullit". Emrin e Ali Demit e mbajnë rrugë dhe shkolla të ndryshme në Shqipëri, veçanërisht në Tiranë dhe në Vlorë. Për të janë shkruar libra dhe bërë monografi, janë bërë buste dhe është pasqyruar në artet figurative. Ai është Dëshmor i Atdheut dhe varri i tij gjendet në vorrezat e Dëshmorëve në Vlorë. Në këtë përvjetor të 75 të rënies heroike të tij, populli i trevës së Labërsië përulet me nderim para veprës së lartë atdhetare të këtij biri të shquar të Çamërisë.



25 DHJETOR 2018

93 vjet Forca Detare

Më datën 19 dhjetor 2018, në Komandën e Forcës Detare, Plepa, Durrës, u festua 93-vjetori i Krijimit të Flotës sonë Luftarake Detare. Morën pjesë Ministri i Mbrojtjes zonja Olta Xhaçka, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave, Gjeneralbrigade Bardhyl Kollcaku, Komandanti i Forcës Detare, Gjeneralmajor YlberDogjani, ish-Presidenti Rexhep Mejdani, kuadro të Ministrisë së Mbrojtjes, familjarë, etj.

"Në këto 93 vite, deklaroi ministrja Xhaçka, Forcat Detare janë dalluar për profesionalizmin, kulturën, vullnetin e përkushtimin në kryerjen e misionit fisnik për mbrojtjen e kufijve dhe zbatimin e ligjshmërisë detare, duke bashkëvepruar me strukturat e tjera të shtetit shqiptar".

"Gjatë kësaj rruge shekullore, ku bashkohet kontributi i disa brezave, përfshihet dhe roli i pazëvendësueshëm i detarëve me uniformë, të cilët në vite, me sakrifica, vështirësi, guxim e heroizëm, duke u përballur me dallgët e detit, gjatë lundrimeve pa fund, ditë e natë, në mot të qetë e të trazuar, kanë shkruar historinë e tyre të lavdishme, si pjesë integrale e Historisë së Popullit Shqiptar", tha ministrja Xhaçka.

Krahas modernizimit është punuar për arësimimin dhe kualifikimin e kuadrove e personelit të anijeve si brenda dhe jashtë vendit. Gjatë këtyre 28 viteve, vetëm në SHBA, janë kualifikuar në shkolla dhe akademi të ndryshme detariembi 100 kuadro detarë të rangjeve të ndryshme.

Bashkë me festën e Forcës Detare, u kremtua dhe 100 vjetori i lindjes së K/Admiralit Abdi Mati. Data 25 dhjetor 1925, u caktua si dita e krijimit të Flotës Luftarake, në një Vendim Qeverie, në korrik të vitit 1992.





